Udhëzues për Rininë mbi Gazetarinë Qytetare



Jour-You

AKADEMIA E GAZETARISË QYTETARE PËR TË RINJTË

ERASMUS-YOUTH-2021-CB-101052000

Co-funded by
the European Union

Jour-You

AKADEMIA E GAZETARISË QYTETARE PËR TË RINJTË

ERASMUS-YOUTH-2021-CB-101052000

jour-you.eu

Udhëzues
për
Rininë
mbi
Gazetarinë Qytetare

Version 1.01 15 Maj 2023

Përgatitur nga Mihail Minchev (FECE)

Me kontributin e partnerëve të projektit

Disclaimer

Financuar nga Bashkimi Evropian. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura janë vetëm të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Komisionit Evropian. As Bashkimi Evropian, as autoriteti i dhënies së grantit nuk janë përgjegjës për to

Përmbajtja

Parathënie 3

Hyrje 5

Karakteristikat e Gazetarisë Qytetare 5

Parimet e Gazetarisë Qytetare 6

Pse është e rëndësishme Gazetaria Qytetare? 7

Shembuj mbresëlënës të gazetarisë qytetare

Revista Online, Gazetari Komunitare dhe Publikime Investiguese 10

Citizens Channel 10

Lo Spiegone 12

Binario2 Il Giornale 13

Scomodo 14

La Politica Del Popolo 15

De Re Militari Journal 16

7iber 18

El-Shafra 19

Al Qatiba 20

Nawaat 21

Inkyfada 22

Platformat për verifikim të fakteve 24

Faktoje 24

Faktograf 26

Demagog 27

Factcheck.Bg 29

Ellinika Hoaxes 30

Fatabyyano 31

Iniciativa Edukuese 34

Edukimi Mediatik dhe Informativ 34

Manual me burime të hapura 35

Koalicioni i Edukimit Mediatik 37

Psaloroco 38

Rrjeti i Organizatave të Edukimit Mediatik 40

Siguria në internet dhe Programet e Mbështetjes Profesionale 42

Qytetaria Dixhitale dhe Parandalimi i Zhvatjeve Kibernetike 42

Mbështetja e Mediave Ndërkombëtare 43

Sofizmi 45

Digital Legal Clinic 46

Konkluzionet 48

Referencat 50

Jour-You



Parathënie

Gazetaria qytetare është bërë një aspekt gjithnjë e më i rëndësishëm i hapësirës mediatike në vitet e fundit. Me rritjen e përdorimit të mediave sociale dhe demokratizimit të informacionit, gjithnjë e më shumë individë po marrin rolin e reporterëve, duke dokumentuar ngjarje dhe duke ndarë histori që në të kundërt do të mbeteshin të patreguara. Për këtë arsye, ne kemi vendosur të shpjegojmë në këtë udhëzues se cili është thelbi i gazetarisë qytetare dhe të paraqesim disa nga praktikat më të mira nga e gjithë bota. Duke u mbështetur në shembujt e gazetave online, nismat e gazetarisë komunitare, botimet investigative, platformat e verifikimit të fakteve, iniciativat edukuese dhe programet mbështetëse profesionale online mbi sigurinë, ne do të pasqyrojmë 21 shembuj të gazetarisë qytetare të realizuar në mënyrë të duhur. Ne kemi synuar të ofrojmë një analizë të hollësishme të secilit shembull, duke iu përgjigjur tre pyetjeve kryesore: **çfarë e bën nismën të shkëlqyer, çfarë ndryshimi sjell dhe si mund të adoptohet**, për të qenë lehtësisht e kuptueshme nga lexuesi. Shembujt janë të ndarë në 4 kategori. Ne besojmë se kjo qasje do t'i lejojë lexuesit të fitojnë njohuri mbi praktikat më të mira të gazetarisë qytetare nga e gjithë bota dhe t'i zbatojnë ato në punën e tyre.

Duke pasur parasysh se gazetaria qytetare ka fuqinë të formësojë diskursin publik, të bëjë llogaridhënës ata të cilët janë në pushtet edhe t'u japë zë atyre që në të kundërt mund të mos dëgjohen, ne kemi vendosur të ndërmarrim detyrën e udhëzuesit jo vetëm për t'i njohur lexuesit me disa koncepte bazë në këtë fushë, por edhe për t'i fuqizuar dhe frymëzuar ata, duke shpresuar që ata vetë të marrin përsipër këtë detyrë të rëndësishme. Lexuesit mund të marrin njohuri më të gjerë mbi gazetarinë qytetare, rëndësinë dhe disa nga parimet e saj. Gjithashtu ata mund të mësojnë rreth disa prej praktikave më të mira në këtë fushë, si kanë kontribuar dhe si munden të përshtaten këto praktika nga gazetarë qytetarë aspirantë. Si përfundim, nëse jeni një gazetar i njohur, dikush që është i interesuar të kontribuojë në procesin e krijimit të lajmeve, dikush që punon në fushën e gazetarisë dhe doni të zgjeroni iniciativen tuaj ose thjesht dikush që është kurioz të dijë më shumë rreth temave lidhur me gazetarinë qytetare, ky udhëzues ofron këshilla praktike dhe frymëzim për të gjithë.



Hyrje

Në vitet e fundit, zhvillimet teknologjike kanë arritur në një pikë ku ne thjesht duhet të marrim nga xhepat apo çantat tona mjetet dixhitale, nëse duam të shohim një projekt për punë, të zbulojmë të gjitha llojet e argëtimit cilësor dhe informacione të vlefshme apo thjesht të kontrollojmë për një mik që po jeton në anën tjetër të globit. Ndërsa kërkojmë nëpër email-et tona për atë version të planit të projektit, të përditësuar ose zgjedhim se cilën video të ndajmë si "story", ne priremi të harrojmë se **telefonat** tanë inteligjentë e të aftë mund të kthehen gjithashtu **në një mjet për transformimin e komuniteteve tona dhe për të mbështetur parimet demokratike.** Ne vetëm duhet t'i përdorim këto mjete dixhitale në drejtimin e duhur dhe të dokumentojmë incidente dhe praktika që janë shqetësuese, ndikuese ose frymëzuese. Ekziston edhe një term për këtë - **gazetari qytetare.** Tani që platformat e **mediave sociale** janë bërë normë për shpërndarjen e **lajmeve**, **raportimi i qytetarëve dhe qasjet editoriale nga poshtë-lart** po fitojnë gjithnjë e më shumë vëmendje. Përditësimet në Twitter, ngjarjet në Facebook dhe videot në YouTube ishin të rëndësishme për organizimin e aktivistëve gjatë Pranverës Arabe dhe tërhoqën vëmendjen ndërkombëtare gjatë protestave në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme. Megjithatë, duhet theksuar se fenomeni i joprofesionistëve që krijojnë përmbajtje të denjë për mediat, nuk ka filluar në epokën dixhitale, siç edhe ilustrohet nga videoja e prodhuesit të veshjeve Abraham Zapruder për vrasjen e John F. Kennedy[1]. Pikërisht ky filmim i jashtëzakonshëm i regjistruar gati 60 vjet më parë, mishëron gazetarinë qytetare - **një anëtar i audiencës, jo një reporter i trajnuar, përdor mjetet e shtypit që disponon** (një videokamerë) **për të gjeneruar një pjesë informative dhe për të dhënë një kontribut në media.**[2] Për të kuptuar më mirë termin e gazetarisë qytetare dhe shembujt e lidhur me to, duhet të shkojmë përtej këtij përkufizimi të drejtpërdrejtë dhe të shohim karakteristikat mëposhtë.

Karakteristikat e Gazetarisë Qytetare[3,4,5]

- **Jo të orientuara drejt fitimit** - shumica e iniciativave të gazetarëve qytetarë vetëfinancohen dhe/ose mbështeten me donacione. Qëllimi i tyre nuk është të tërheqin reklama apo të bëjnë publicitet.
- **Pa trajnime formale** - lajmet dhe raportet krijohen nga njerëz që nuk kanë diploma në gazetari.
- **Mënyra e decentralizuar e funksionimit, procesi nga poshtë-lart** - gazetarët qytetarë nuk janë pjesë e një strukture të përcaktuar editoriale ose

biznesi, por organizohen në mënyrë të tillë për të shpërndarë informacion ekskluzivisht nga komunitetet dhe zonat e tyre.

- **Gamë e gjerë e këndvështrimeve** - përfshirja e qytetarëve të zakonshëm në procesin e krijimit dhe përhapjes së lajmeve çon në paraqitjen e këndvështrimeve të ndryshme, të cilat nuk mbulohen nga mediat tradicionale.
- **Nuk ka standarde të përcaktuara formimi apo redaktimi** - gazetarët qytetarë nuk u përmbahen standardeve në lidhje me gramatikën, citimin, stilin, numrin e fjalëve të artikujve, burimin, privatësinë, etj. Veprimtaria përtej kufijve të ngurtë të raportimit tradicional dhe prodhimit të lajmeve lë hapësirë për qasje inovative.
- **Shkallë e lartë e menjëhershmërisë** - gazetarët qytetarë nuk kanë nevojë të marrin miratimin nga redaktorët ose të respektojnë politika të caktuara editoriale, gjë që u mundëson atyre të raportojnë për çështjet që dëshmojnë menjëherë dhe madje ndonjëherë të transmetojnë lajmet në kohë reale.
- **Zbulimi i temave të reja për mediat tradicionale** - meqenëse shumica e qytetarëve aktivë janë të lirë nga axhendat e korporatave apo axhenda të tjera specifike, ata e ndajnë lehtësisht atë që shohin dhe i përjetojnë duke vënë në pah çështjet e komunitetit, të cilat anashkalohen nga mediat kryesore.
- **Kontributi në demokratizimin e shoqërisë** - reportazhet dhe transmetimet e drejtpërdrejta të gazetarëve amatorë për probleme të ndryshme shoqërore dhe institucionale arrijnë shpejt një audiencë të gjerë nëpërmjet platformave të mediave sociale dhe nxitin veprime transparente nga ana e qeverisë. Kjo është thelbësore në vendet ku ka censurë ku burimet e besueshme të informacionit bllokohen, praktikat e gazetarisë qytetare bëhen të rëndësishme në rrugën drejt rivendosjes së sundimit demokratik, pasi ato gjenerojnë lajme të besueshme dhe vënë në dyshim taktikat e qeverisë.

Sado tërheqëse mund të duken këto karakteristika, sugjerimi ynë është të mos futeni ende në "këpucët e një gazetari qytetar" përpara se të njiheni mirë me katër parimet e Gazetarisë Qytetare të përgatitura nga Qendra e Medias Qytetare.

Parimet e Gazetarisë Qytetare[5]

- **Saktësia:** Kontrolloni gjithmonë të gjitha faktet e historisë tuaj dhe besueshmërinë e burimeve tuaja. Sigurohuni që të korrigjoni menjëherë çdo gabim faktik dhe të përditësoni publikimin tuaj me informacione të reja dhe relevante.
- **Përpikëria:** Merrni sa më shumë njohuri që të jetë e mundur për temën që po mbuloni dhe listoni të gjitha burimet tuaja origjinale.
- **Drejtësia:** Merrni parasysh pikëpamjet e ndryshme dhe ofroni një raport të balancuar.

- **Transparenca dhe Pavarësia:** Ndani një perspektivë të pavarur mbi çështjet duke shpjeguar të gjitha paragjykimet dhe konfliktet e mundshme. Çdo lidhje e drejtpërdrejtë me një palë të interesuar mund të rrezikojë objektivitetin tuaj.

Respektimi i parimeve të mësipërme është thelbësor gjatë ushtrimit të gazetarisë qytetare. Një kërkesë tjetër jetike është **të kesh një shkallë të lartë të edukimit mediatik**, e cila përfshin aftësinë për të **aksesuar, analizuar** dhe **vlerësuar në mënyrë kritike** aspekte të ndryshme të **mesazheve mediatike** (cilësi, vërtetësi, besueshmëri) dhe gjithashtu për të krijuar **përmbajtje kuptimplotë që pasqyron përvojat personale, bazat e etikës** dhe **përgjegjësinë sociale**. Nga një listë kaq e gjatë kërkesash lind natyrshëm pyetja: *Pse është kaq e rëndësishme për çdo qytetar aktiv që herë pas here të bëhet gazetar?* Epo, lista e arsyeve është edhe më e gjatë.

Pse është e rëndësishme gazetaria qytetare?

Gazetaria qytetare i referohet aktit të individëve joprofesionistë, që nuk janë domosdoshmërisht gazetarë, të cilët raportojnë lajme dhe ngjarje të cilat ndodhin në komunitetet e tyre. Ky akt është mbledhja, shpërndarja dhe analizimi i informacionit nga publiku i gjerë, që në ditët e sotme bëhet më së shumti nëpërmjet internetit. Gazetaria qytetare është bërë një pjesë e rëndësishme e ekosistemit të lajmeve, veçanërisht në kohë krize, ku fillimisht ka treguar se ka avantazhin ndaj mediave konvencionale në paraqitjen e perspektivave të shpejta personale dhe të larmishme rreth ngjarjeve të vëzhguara. Kjo do të thotë se gazetaria qytetare jo vetëm që kontribuon në demokratizimin e shoqërisë, pasi ajo sjell më shumë zëra në arenën publike, për një demokraci më vitale, por gjithashtu krijon pluralizëm në media, duke promovuar një sërë këndvështrimesh në dispozicion të publikut. Si një komponent i rëndësishëm i peizazhit modern mediatik, rëndësia e gazetarisë qytetare është rritur gjithnjë e më shumë. Më poshtë janë listuar disa pika shtesë që theksojnë rëndësinë e kësaj praktike:

Tërheq vëmendjen e publikut për problemet e komuniteteve të vogla.[5] Mediat kryesore shpesh nuk kanë kapacitetin ose lirinë editoriale për të mbuluar çështje të veçanta për të cilat ia vlen të raportohet. Kjo është arsyeja pse ndonjëherë u takon anëtarëve të komunitetit që të publikojnë betejat dhe kërkesat e tyre duke përdorur burimet dhe platformat që kanë në dispozicion.

Lufton lajmet e rreme dhe dezinformimin. Gazetarët qytetarë kanë njohurinë e duhur të brendshme mbi proceset në komunitetet e tyre dhe mund mënjanojnë lehtësisht narrativat e rreme, të korrigjojnë lajmet e rreme dhe të kundërshtojnë dezinformimin përmes raportimit të sinqertë dhe të bazuar në fakte.

Mbështet parimet kryesore demokratike.[3,5,7] Nëpërmjet publikimeve të

tyre gazetarët qytetarë përforcojnë zërat e anëtarëve të tjerë të komunitetit dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në pluralizmin e opinioneve në media dhe në promovimin e transparencës.

Komuniteti i kampionëve përmes mbulimit emocional. Meqenëse gazetarët qytetarë nuk duhet t'i përmbahen një politike të caktuar editoriale ose të pajtohen me kërkesat e reklamuesve, ata janë të lirë të prodhojnë raporte të drejtuara nga emocionet, të cilat shpesh rezonojnë te një audiencë e gjerë dhe tërheqin mbështetje për kërkesat e komuniteteve lokale.

Kontriboun në shtimin e një perspektivë lokale për çështjet e mbuluara gjerësisht.[5] Gazetarët e mirë qytetarë mund të parashtrojnë pikëpamjet e anëtarëve të komuniteteve të tyre për çështjet mbarëkombëtare dhe të rrisin shtrirjen e perspektivave të reja lokale, të cilat nga ana e tyre mund të nxisin qasje më efikase për zgjidhjen e problemeve të caktuara.

Raportimi i lajmeve flash përpara se të tjerët të thonë "lajm i fundit". Duke qenë në lëvizje dhe të pavarur nga ekipet e produksioneve, gazetarët qytetarë shpesh mbërrijnë në pikat e nxehta përpara përfaqësuesve të mediave kryesore dhe transmetojnë ngjarje kur ato ndodhin në kohë reale.

Zhvillon aftësi të reja. Në procesin e të bërit të një gazetari qytetar me përvojë, ju rritni aftësitë tuaja të të menduarit kritik, mësoni se si të njihni vlefshmërinë e burimeve dhe të kuptoni axhendën e një burimi informacioni, rrisni aftësitë e të rrëfyerit të historive (storyteller), filloni të dalloni faktet nga opinioni, fitoni aftësi për filtrimin e informacionit, mësoni se si të hulumtoni mbi një temë në tërësi dhe të citoni burimet tuaja, zotëroni praktika të mira të sigurisë në internet, mësoni se si të promovoni përmbajtje në platformat e mediave sociale dhe të rritni kreativitetin tuaj audio-vizual midis aftësive dhe kompetencave të tjera.

Duke pasur parasysh këto, është e rëndësishme të theksohet se gazetaria qytetare nuk është shërim për problemet e shumta që kanë të bëjnë me gazetarinë tradicionale apo mediat konvencionale. Gazetaria qytetare ka kufizimet e saj, si potenciali për keqinformim, mungesa e mbikëqyrjes editoriale, rreziku i dëmtimit të gazetarëve qytetarë, mungesa e kodit etik institucional etj. Prandaj, është thelbësore që gazetarët qytetarë dhe gazetaria qytetare si praktikë t'u përmbahen standardeve dhe etikës gazetareske, si verifikimi i fakteve, verifikimi i burimeve dhe raportimi i drejtë edhe pse nuk ka rregulla apo rregullore strikte të mirëpërcaktuara.

Në përgjithësi, gazetaria qytetare luan një rol të rëndësishëm në shoqëri jo vetëm me potencialin e saj për të mbështetur vlerat demokratike, për të informuar publikun dhe për të kontribuar në transparencën e medias, por edhe me mundësinë e saj për të sjellë perspektiva lokale në ngjarje të ndryshme dhe "për të raportuar flash " lajmet e fundit.

Pra, nëse jeni një gazetar frymëzues, një profesionist më përvojë, ose thjesht dikush i interesuar në këtë fushë, ju inkurajojmë të lexoni citimet e

mëposhtme, të cilat janë zgjedhur me kujdes për t'ju njohur më nga afër me botën e gazetarisë, t'ju frymëzojnë dhe t'ju ndihmojë të kuptoni më thellë se çfarë është gazetaria, qoftë ajo qytetare apo konvencionale.

"Gazetaria, ashtu si demokracia, nuk është diçka që arrihet. Është një punë në progres dhe jo çdo ditë shkon aq mirë si një ditë mëparë."

- John Maxwell Hamilton

"Nuk mund të ketë ligj më të lartë në gazetari sesa të thuash të vërtetën dhe të turpërosh djallin."


- Walter Lippmann

"Gazetaria nuk mund të heshtë kurrë: ky është virtyti i saj më i madh dhe faji më i madh. Ajo duhet të flasë dhe të flasë menjëherë, kur jehona e habisë, pretendimet e triumfit dhe shenjat e tmerrit janë ende në ajër."

- Henry Anatole Grunwald

Siç mund ta imagjinoni, bota e gazetarisë, qoftë qytetare apo konvencionale, është vazhdimisht në ndryshim dhe kërkon që individët të kenë një kuptim të thellë të asaj që me të vërtetë do të thotë të jesh gazetar. Duke ju ndihmuar në zgjerimin e këndvështrimit tuaj mbi rëndësinë e gazetarisë qytetare, ju mund të ndjeheni të tunduar të nxitoni për të dalë në rrugë dhe të kërkoni përmbajtje me vlerë lajmi duke përdorur telefonin tuaj. Por, përpara se të shkoni dhe ta bëni këtë, sigurohuni që të eksploroni mënyrat specifike se si mund të ndikoni si gazetar qytetar përmes praktikave më të mira që kemi përpiluar nga vende të ndryshme të botës, të cilët mund t'i gjeni në kapitujt e mëposhtëm.

Shtetet Pjesëmarrëse



Shembuj Konkretë të Gazetarisë Qytetare

Revista Online, Gazetari Komunitare dhe Publikime Investiguese

1 Citizens Channel: Raportimi me njerëzit, jo për njerëzit

Çfarë ka të mrekullueshme "Citizen Channel" ?

"Citizens Channel (CC)" është një OJF mediatike e krijuar në Shqipëri dhe e menaxhuar nga profesionistë të rinj, që synon të shërbejë **si një hapësirë e lirë dhe e pacensuruar për zhvillimin e gazetarisë qytetare dhe zërave të përgjegjshëm** të cilët promovojnë **vlera demokratike si** dhe **të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.**

Fillimisht i nisur si projekt në vitin 2016, "Citizens Channel" ka bërë një hap të rëndësishëm për t'u bërë Qendër e pavarur në korrik 2018. Gjatë këtyre viteve CC ka zbatuar **një sërë projektesh dhe nismash** të fokusuara në **gazetarinë e angazhuar dhe komunitare** Për sa i përket kapaciteteve prodhuese, ekipi i "Citizens Channels" përpiqet të ofrojë një minimum javor prej 10 produktesh gazetareske multimediale, duke i dhënë përparësi videove, shkrimeve të gjata dhe raportimeve të thelluara.

Redaksia e CC synon të prezantojë **një model të ri** gazetarie në Shqipëri **që plotëson hapësirën** midis **çështjeve me të cilat përballen qytetarët e thjeshtë dhe komunitetet e margjinalizuara** dhe **prioriteteve të raportimit të mediave kryesore,** në atë që mbetet si një mjedis informacioni shumë i polarizuar.

Si një organizatë mediatike e drejtuar nga misioni, CC ka një manifestim të vlerave thelbësore, të cilat shfaqen në kreun e faqes së saj zyrtare web dhe e bën transparent një angazhim jo vetëm për të prodhuar raporte me cilësi të lartë, por edhe për të pasur një rol aktiv dhe të orientuar drejt zgjidhjes së çështjeve që lidhen me lirine e medias, të drejtat e punës së gazetarëve të rinj dhe të drejtat e njeriut.

Motoja e "Citizens Channel" është: "Çdo gazetar i mirë është aktivist i së vërtetës, në favor të transparencës dhe në emër të llogaridhënies".

Aktivitetet kryesore të organizatës përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Redaksia dixhitale** – Zhvillohet dhe operohet nga katër gazetarë, një kryeredaktor dhe një redaktor vizual;
- **Platforma online për ngritjen e kapaciteteve** – ofron module falas të mësimit në distancë mbi instrumenta si Multimedia, Edukimi mediatik dhe Aktivizimi Kreativ;
- **Platforma kërkimore** – Histori urbane të treguar nga qytetarët që synojnë evidentimin dhe shënjimin e vilave që përbëjnë trashëgimi kulturore për Tiranën.

Çfare ka të veçantë "Citizens Channel" ?

Përmbajtja e videove të "Citizens Channel" ka tërhequr më shumë se 2.8 milionë shikues gjatë 12 muajve të fundit. Janë prodhuar mbi 150 video dhe më shumë se 200 artikuj dhe raporte investiguese ekskluzive.

Si një media udhëheqëse e angazhuar në raportimin komunitar, "Citizens Channel" ndiqet nga disa grupe joformale, OJF dhe rrjete profesionale që ndajnë dhe angazhohen rregullisht me përmbajtjen e organizatës dhe e përdorin atë si burim informacioni.

Si mund ta adoptoni modelin e CC?

Nëse do të hapni një platformë online të gazetarisë qytetare, sigurohuni që **të vendosni politika solide editoriale** dhe **t'u përmbaheni standardeve të larta gazetareske.** Promovoni në çdo kohë **ndërveprimin midis audiencës dhe reporterëve**. Përdorni **qasje inovative** dhe shfrytëzoni **mundësitë** që ofron **mjedisi dixhital,** qëndroni të **hapur ndaj risive.**

Mbani gjithmonë **një sy tek statusi i sigurisë kibernetike** të platformës suaj dhe **jini gati për të përballuar dhe kundërpërgjigjur sulmeve kibernetike**


Mësoni më shumë :

Faqja zyrtare web e Citizens Channel

Platforma online për ngritjen e kapaciteteve

Histori Urbane

Tiranë 2031 – një seri hetimesh për çështje urbane



2 **Lo Spiegone:** Qasja e gazetarisë në formë të gjatë tek një audiencë e gjerë (Longform Journalism)

Lo Spiegone
In Trouble Be Clear

Çfarë ka të mrekullueshme "Lo Spiegone"?

"Lo Spiegone" është **një botim, një revistë online** e themeluar nga pesë studentë të programit "Marrëdhëniet Ndërkombëtare" në Universitetin Sapienza të Romës me objektivin **për të ofruar artikuj të gjatë të besueshëm, depërtues dhe cilësor mbi ngjarjet aktuale** dhe **çështjet globale** që **nuk mbulohen nga shtypi kryesor italian. Burimet** e përdorura gjatë një investigimi të caktuar dhe gjatë shkrimit të një artikulli **renditen gjithmonë** në fund, **duke krijuar kështu besim** te lexuesit dhe **duke i frymëzuar ata** për **të eksploruar** më tej temën. **Vëmendje** e veçantë i kushtohet **gjuhës**, e cila është e **aksesueshme për njerëzit** me **nivele të ndryshme arsimore** dhe **lehtëson të kuptuarit e proceseve** globale dhe **ndikimin e tyre në çështjet kombëtare.** Shpesh duke iu referuar punës së tyre si **"gazetari e ngadaltë"**, **ekipi** që qëndron pas revistës përbëhet nga **ekspertë** të **fushës ligjore, politikës ndërkombëtare, mbrojtjes së mjedisit dhe ekonomisë** dhe **specialistë të aftë të mediave sociale.** Të gjithë anëtarët e ekipit udhëhiqen nga **parimet** e **ndershmërisë intelektuale, transparencës, pavarësisë editoriale, paanshmërisë** dhe **rëndësisë përgjatë përpjekjeve** të tyre të përditshme gazetareske. Aspektet promovuese dhe administrative lidhur me drejtimin e botimit online menaxhohen **nga organizata jofitimprurëse** "Lo Spiegone APS", **palët e interesuara** të së cilës përbëjnë **stafin editorial** dhe **profesionistë të tjerë të përfshirë** në projekt.

Çfare ka të veçantë "Lo Spiegone" ?

Trafiku në faqen e internetit është rritur vazhdimisht dhe pritet të arrijë në një milion vizita këtë vit. Shumë lexues ndanë komente pozitive për cilësinë e përmbajtjes dhe u frymëzuan të klikonin në burimet e listuara në fund të artikujve. Redaktorët e "Lo Spiegone" morën shumë ftesa për ekspozita dhe konferenca të specializuara. Suksesi i revistës doli të ishte mjaft ndikues, fakt që çoi në daljen e botimeve të tjera të**"gazetarisë së ngadaltë"**.

Si mund ta adoptoni modelin "Lo Spiegone" ?

Gjeni **vendin e duhur për projektin tuaj,** ruajini **vlerat e ndershmërisë dhe integritetit intelektual** dhe sigurohuni që **komunikimi** brenda ekipit të jetë **i qetë** dhe t**ë gjithë njerëzit e përfshirë** në projekt **të shpërblehen** me një **ndjenjë pronësie dhe përkatësie.** Krijimi i **një komuniteti** dhe **një hapësire të sigurt** është **thelbësor** për ndërtimin e një **grupi të lidhur ngushtë dhe të motivuar** që do të mbështesë aktivitetet e përditshme të projektit dhe do të marrë pjesë në mënyrë aktive **në rritjen dhe inovacionin e tij.**

Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e "Lo Spiegone"

3 **Binario2 Il Giornale:** Forcimi i Komunitetit Lokal përmes Gazetarisë

Çfarë ka të mrekullueshme "Binario2 Il Giornale" ?

"Binario2 Il Giornale" ka lindur brenda Shoqatës së Promovimit Social "RacaleCam". Organizata, e cila aktualisht operon me një laborator urban në Racale (Le) Itali, ndër vite ndërthur traditën me inovacionin. Fillimet e saj mund të gjurmohen në një festë fetare të qytetit, për të cilën ajo hapi një stacion radiofonik dhe përcolli historinë e mahnitshme të komunitetit lokal në botë përmes intervistave me zyrtarë, përfaqësues të shoqatave dhe qytetarë. Projekti aktual mbi informacionin "Binario2" përbëhet nga **një botim në internet** i përditësuar çdo javë, një **botim i shtypur cdo gjashtë muaj** dhe një **radio në internet. Ai** drejtohet nga **një ekip redaktues të përbërë prej disa të rinjsh** nga stacioni i vjetër i trenit Racale, i cili tani shërben si një qendër (hub) inovative në jug. Të gjithë redaktorët janë nën 35 vjeç dhe shpesh **paraqesin artikuj të shkruar nga nxënës** të shkollave të mesme. Qëllimi i projektit është **të përmirësojë trashëgiminë jomateriale lokale** dhe të dokumentojë **përvojat e komunitetit në një mënyrë tërheqëse** si në internet ashtu edhe në shtypin e shkruar "Binario2 Il Giornale - zërat e territorit".

Duke marrë parasysh që shumë bashki të vogla, si ajo në të cilën fokusohet "Binario2 Il Giornale", nuk marrin shumë mbulim në lajmet e mediave tradicionale, **një projekt gazetaresk me qasje nga poshtë-lart** ndihmon në shpërndarjen e informacionit lokal dhe hedh dritë mbi ngjarjet me ndikim pozitiv, duke forcuar kështu komunitetin.

Çfare ka të veçantë "Binario2 Il Giornale"**?**

Binario2 Il Giornale i bën lajmet lokale të aksesueshme për të gjithë pa pagesë. Botimi i tij në formë të shtypur i kapërcen ndarjet, vështirësitë e epokës dixhitale duke angazhuar edhe qytetarë të moshuar që nuk ndihen të sigurt për të përdorur smartfonë dhe pajisje kompjuterike. I gjithë projekti mbi informacionin stimulon të rinjtë të shkruajnë, të ushtrojnë aftësitë e tyre të të menduarit kritik në procesin e kurimit të përmbajtjes, të përmirësojnë aftësitë e tyre të bashkëpunimit dhe të kërkojnë komunikim midis brezave për të diskutuar mbi çështje të ndryshme. Hulumtimi për histori dhe reportazhe shpesh përfshin ndërveprime me anëtarë të ndryshëm të komunitetit dhe kontribuon në një ndjenjë të fortë përkatësie. Anëtarët e ekipi editorial janë të frymëzuar për t'u bërë përdorues të aftë të mjeteve të komunikimit dixhital dhe për të mësuar se si të menaxhojë në mënyrë të qëndrueshme një projekt gazetaresk të shumëanshëm. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, partneriteti i "Binario2 Il Giornale" me shkollat siguron mbulimin e iniciativave dhe arritjeve arsimore që përndryshe nuk do të merrnin vëmendjen që meritojnë.

Si mund ta adoptoni modelin e "Binario2 Il Giornale" **?**

Për të krijuar një projekt editorial me qasje nga poshtë-lart, është thelbësore **të përfshihen aktorë të ndryshëm kombëtarë dhe rajonalë, si dhe profesionistë nga fusha të ndryshme,** të cilët më pas do të dokumentojnë dhe **mbajnë gjallë historinë e komunitetit. Një rrjet i fortë partneriteti** do ta bëjë projektin më solid dhe të qëndrueshëm.



Për më shumë:

Ngritja e fondeve

Gazeta "Binario2 Il Giornale"

Rreth projektit të radios online web



Çfarë ka të mrekullueshme "Scomodo"?

"Scomodo" është **revista dhe platforma online më e madhe e pavarur,** e besueshme dhe **e shpërndarë falas për personat nën 25** vjeç në Itali. Ekipi i tij editorial përbëhet nga **studentë** që ndjekin një **qasje nga poshtë lart** dhe herë pas here **bashkëpunojnë me ekspertë dhe partnerë** si "Banca Etica" dhe "Greenpeace" për të ofruar **artikuj të aksesueshëm, kritik dhe të thelluar** që pasqyrojnë **këndvështrimet e brezit të ri** mbi **tema politike, rëndësinë sociale dhe kulturore.** Shumica e **hulumtimeve gazetareske** kryhen **në terren** dhe përfshijnë **intervistimin e qytetarëve** dhe **verifikimin personalisht** të pretendimeve të institucioneve. **Vëmendje** e veçantë i kushtohet çështjeve mjedisore, çështjeve gjinore, **problemeve psikologjike, sociale dhe të strehimit,** fenomeneve të diskriminimit, **edukimit, formave të shtypjes, "para-rojë" (avant-garde) i kulturës** dhe fenomeneve në ndryshim.

I nxitur nga **kurioziteti, guximi, paanshmëria** dhe besimi i fortë **në vlerat demokratike dhe mundësitë e barabarta,** Scomodo synon të:

- **zhvillojë gazetarinë e ngadaltë dhe shtypin e shkruar** që **lufton lajmet e rreme** dhe **infodeminë** e gazetarisë dixhitale dhe të shpejtë;
- **promovojë gazetarinë e pavarur** dhe kritike që zgjedh **tema të cilat nuk mbulohen nga mediat kryesore** dhe t'i prezantojë ato përmes këndvështrimit të ndryshëm (countercultural);
- **inkurajojë protagonizmin rinor** duke sfiduar kështu narrativën dominuese që i përshkruan të rinjtë si pertacë dhe të paaftë për të formësuar realitetin rreth tyre.

Përveç ofrimit falas të informacionit të besueshëm dhe analizave të thelluara të çështjeve aktuale, Scomodo **realizon projekte** në fushën e **inovacionit dhe edukimit social:** seminare **mbi gazetarinë pjesëmarrëse,** zhvillimin e rrjeteve territoriale të shoqatave, **lehtësimin e aksesit në ndihmë psikologjike** për të rinjtë dhe asistencë në shkollë për fëmijët.

Çfare ka të veçantë Scomodo ?

Deri tani Scomodo ka përfshirë 1,000 vajza dhe djem, ka shtypur 315 000 kopje, ka shpërndarë pothuajse 280 000 pa pagesë, ka hapur dy qendra rinore, ka krijuar një ekosistem prej më shumë se 20 projektesh dhe një komunitet të qëndrueshëm me më shumë se 1,000 njerëz në mbarë Italinë.

Shumë të rinjve të komuniteteve të ndryshme iu dha mundësia të shprehen, të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre dhe të mësojnë bazat e një profesioni, i cili është thelbësor në kohën e atomizimit social dhe depresionit ekonomik.


Si mund ta adoptoni modelin Scomodo?

Këshillat mund të ndahen në **motivuese dhe menaxheriale:**


- motivuese: **jini të guximshëm,** argëtohuni me miqtë dhe **krijoni një komunitet;**
- menaxheriale: **zgjidhni një** ose maksimumi **dy iniciativa, angazhoni njerëz** si **në hartimin e ideve** ashtu edhe **në detyra praktike.** Bërja e gjërave së bashku krijon një lëvizje!


Mbani mend se një "martesë" e mirë midis **ideve, guximit dhe komunitetit** mund **të ndryshojë realitetin** rreth jush.

Mësoni më shumë :
Faqja zyrtare e revistës Scomodo
TED talk nga ana e një prej themeluesve të Scomodo
Artikull për Scomodo tek gazeta "la Repubblica"













5 La Politica Del Popolo: Fuqizimi I të Rinjve për të marrë Vendime të Informuara mbi të Ardhmen e Tyre

Çfarë ka të mrekullueshme La Politica Del Popolo **?**

La Politica del Popolo (Politika e Popullit) është një **faqe italiane e lajmeve, e menaxhuar** dhe e **redaktuar nga të rinj** që përpiqen **t'i afrojnë bashkëmoshatarët e tyre me ngjarjet aktuale** dhe të paraqesin **informacione pa paragjykime** apo **kushte politike. Artikuj të ndryshëm informativ shpërndahen rregullisht në të gjitha platformat kryesore sociale** për **të inkurajuar mendimin kritik** në **gjeneratat e reja** të cilët përpiqen të gjejnë **pika referimi** në mediat tradicionale që i perceptojnë ato si një demografi tjetër dhe jo **si qytetarë të së nesërmes. Kjo f**aqe **mbulon** tema lidhur me fushat e **politikave kombëtare dhe ndërkombëtare, sportit dhe artit** dhe **bashkëpunon** me **shtëpi botuese** të mëdha dhe **gazetat kryesore italiane** në projekte të caktuara siç është podkasti "Think Freely".

Ideja për krijimin e "La Politica del Popolo" **u konceptua mbi tavolinën** e një **shkolle të mesme në Siçili** - rajoni më jugor i Italisë që mban **rekordin e braktisjes së shkollës** me një normë prej 21.1%, pothuajse dyfishi i mesatares kombëtare prej 12.7%.

Frymëzimi erdhi nga të **kuptuarit** se shumica **e studentëve nuk njiheshin me figurat kryesore politike** dhe kishin shumë pak ide mbi funksionimin e sistemit politik italian. Në një përpjekje për **të ndryshuar** këtë **prirje** shqetësuese, themeluesi i faqes, Paolo Di Falco, vendosi **të krijojë një hapësirë** ku të **rinjtë** mund të **gjejnë informacion të besueshëm** për vendimet në lidhje me të ardhmen e tyre dhe **të kenë akses** në **trajnime bazë mbi gazetarinë, ilustruar** përmes **sfidave praktike.**

- **Çfarë ka të veçantë La Politica del Popolo?**

Versioni i vjetër i faqes është vizituar më shumë se 500,000 herë. Falë projektit, shumë të rinj kanë gjetur rrugët e tyre profesionale dhe nxënësit e shkollave të mesme informohen çdo ditë. Për më tepër, artikujt në faqe kanë tërhequr vëmendjen e figurave publike dhe politikanëve, të cilët pranuan të merrnin pjesë në debate të hapura dhe të njiheshin me pikëpamjet e ekipit të ri redaktues.

- **Si mund ta adoptoni modelin e La Politica del Popolo?**

Tregoni iniciativë dhe **mos e lini veten** të **dekurajoheni ose të hiqni dorë** përballë vështirësive të shumta që mund të shfaqen. **"Bashkimi është forcë"** mund të tingëllojë si një moto klishe, por është mjaft e rëndësishme kur drejtohet një projekt i **përditshëm lajmesh** që **përfshin shumë njerëz që jetojnë** nëpër qytete të ndryshme.

- **Mësoni më shumë:**

Faqja zyrtare e La Politica del Popolo

6 De Re Militari Journal: Përhapja e Njohurive të Thelluara rreth Konflikteve Ndërkombëtare



- **Çfarë ka të mrekullueshme** De Re Militari**?**

De Re Militari është një **grup analistësh** me bazë në Bullgari që ndjekin **zhvillimet e konflikteve** dhe proceseve politike **në mbarë botën. Qëllimi** është **t'i ofrojë** një auditori të gjerë në Bullgari **një kuptim të thellë të proceseve që formësojnë konfliktet ndërkombëtare.** E gjithë puna e tyre është e **disponueshme falas** në internet dhe **është përdorur nga studentë të shkencave politike** në mbarë botën gjatë kërkimit të tyre akademik, si dhe **nga specialistë** të fushës, **OJF** dhe **struktura qeveritare.**

Revista De Re Militari është një **revistë akademike mbi konfliktet, zonat e krizës** dhe **historinë ushtarake,** e themeluar në vitin 2016. Revista fokusohet në proceset politike, **në situatat pas konflikteve në rajone me rëndësi për politikën** dhe **ekonominë** botërore, si dhe në zonat që kanë potencial për t'u bërë zona konflikti.

Parimet kryesore që drejtojnë "De Re Militari" janë:

- **Reduktimi i dezinformimit** në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, sigurisë dhe mbrojtjes, në veçanti lidhur me konfliktet ushtarake dhe politike;
- **Rritja e ndërgjegjësimit të publikut** duke **ofruar informacion të përditësuar dhe të besueshëm** sipas ekspertizës së organizatës;
- **Nxitja e veprimtarisë shkencore dhe akademike** nëpërmjet botimit të punimeve shkencore, raporteve, analizave, studimeve dhe teksteve të tjera mbi temën në fjalë;
- **Krijimi i platformave për zhvillimin e diskutimeve intelektuale** duke përfshirë këndvështrime dhe argumente të ndryshme;
- **Inkurajimi i talenteve të reja** me **interes për sigurinë, shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare,** për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Çfarë ka të veçantë "De Re Militari"?

Ekipi i De Re Militari-t përpiqet të japë informacione të sakta, të konfirmuara nga burime të ndryshme dhe beson se të kuptuarit e situatës në terren është me rëndësi të madhe kur bëhet përpjekje për të kuptuar proceset e ndryshme globale. Një aspekt kryesor i revistës është kombinimi i teksteve koncize dhe hartave të sakta, të cilat plotësojnë njëra-tjetrën në paraqitjen e një tabloje të qartë të një situate të caktuar. Me ndihmën e hartave, ekipi përpiqet të transmetojë dinamika të veçanta, të cilat e bëjnë një konflikt të caktuar më të lehtë për t'u kuptuar si nga specialistët ashtu edhe nga të interesuarit për të mësuar. Seksioni i hartës nuk mbulon vetëm rajonet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, por edhe zona të tjera ku kanë lindur apo po "ziejnë" konflikte.

Si mund ta adoptoni modelin e "De Re Militari"?

Rritja e ndërgjegjësimit publik, krijimi i platformave për angazhim social dhe politik si dhe **promovimi i aktiviteteve shkencore dhe akademike tek një audiencë më e gjerë.** Duke vepruar kështu, më shumë rajone dhe njerëz mund të përfitojnë nga **informacione koherente dhe transparente,** duke kontribuar në luftën **kundër keqinformimit** dhe **mungesës së një këndvështrimi analitik** të **marrëdhënieve dhe politikave ndërkombëtare.**


Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e De Re Militari

Versioni në gjuhën Angleze i gazetës De Re Militari

Intervistë me një nga themeluesit e De Re Militari-t

7iber: Angazhimi në Gazetarinë Investigative që Sfidon Narrativat Kryesore



Çfarë ka të mrekullueshme "7iber" ?

"7iber" u themelua në vitin 2007 si **një blog i gazetarisë qytetare** për të përmbushur një kërkesë për lajme **jashtë narrativave të mediave kryesore** në Jordani. Që atëherë, ajo **ka evoluar** në një **faqe mediatike** dhe një **revistë online** që përpiqet **të mbështesë** vlerat e **llogaridhënies, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe pluralizmit** përmes gazetarisë së thelluar **multimediale, raportimit të pavarur, analizës kritike dhe debatit** të hapur publik. Ekipi që qëndron pas revistës përbëhet nga 12 redaktorë, gazetarë dhe prodhues multimedialë, të cilët u përmbahen **udhëzimeve të mëposhtme:**

- **Ruaj të drejtën për të redaktuar** (lidhur me drejtshkrimin, shenjat e pikësimit dhe stilin) çdo artikull të publikuar në faqe në përputhje me stilin e udhëzuesit;
- **Inkurajo kontributet** e ngjarjeve dhe mendimeve kritike, por që meritojnë respekt dhe që i shtojnë vlerë debateve politike dhe kulturore në Jordani dhe në botën arabe;
- **Inkurajo debat të shëndetshëm** dhe **kërko mendime të kundërta** në mënyrë konstruktive dhe duke treguar respekt;
- **Pranoni kontribute** nga persona **të të gjitha besimeve dhe kombësive.**

Qëllimi kryesor i botimeve të 7iber është **të ndihmojë lexuesit** të kuptojnë **kontekstin dhe dimensionet** e temave të ndryshme dhe **të formojnë opinione** të bazuara **në prova të forta** dhe jo të ndikuar nga diskutimet subjektive në mediat sociale.

Çfarë ka të veçantë "7iber" ?

Një hetim nga Ezz Alnatour, një kontribues i ri në 7iber.com, mbi burgosjen e vazhdueshme të jordanezëve që luftuan në Irak gjatë luftës së 2003, çoi në lirimin e një të burgosuri nga një burg irakien dhe frymëzoi një fushatë avokuese që kërkoi drejtësi për shumë të tjerë. Përveç krijimit të reportazheve investigative me ndikim të lartë, 7iber kryen kërkime mbi qeverisjen e internetit dhe të drejtat dixhitale, ofron shërbime këshillimi dhe mbi prodhimin e lajmeve si dhe organizon seminare trajnimi mbi gazetarinë, gazetarinë multimediale dhe sigurinë dixhitale.

Si mund ta adoptoni modelin e "7iber"?

Suportoni përmirësimin e peizazhit mediatik në vendin tuaj për **të mundësuar** krijimin dhe zhvillimin e **projekteve të pavarura gazetareske.** Vendosini vetes **objektiva realiste** dhe adoptoni një **qasje të shumëanshme** që **angazhon** një sërë **palësh të interesuara:** audienca të targetuara, gazetarë, fotografë, videografë, prodhues multimedialë, verifikues faktesh, organe rregullatore, organizata joqeveritare, kompani mediatike dhe institucione qeveritare. Organizoni **fushata** për **zhvillimin e programeve të specializuara të trajnimit** që synojnë të **rrisin aftësitë** e gazetarëve dhe t'i ndihmojnë ata **të lundrojnë** në rrjedhat komplekse të **informacionit dixhital.**

Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e 7iber

Intervistë me themeluesin e 7iber

8 El-Shafra: Mbulimi i të gjitha Pikëpamjeve për të Ofruar Raporte të Vërteta dhe që Provokojnë Mendime



Çfarë ka të mrekullueshme El Shafra?

El-Shafra është një **program** që **hedh dritë mbi krizat globale politike, ushtarake dhe ekonomike, analizon proceset sociale,** lidh ngjarjet e kaluara me tendencat e tashme dhe të ardhshme dhe **rishikon zhvillimet aktuale** në shkallë lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Ngjarje specifike politike, të sigurisë dhe të inteligjencës, **dokumentohen duke përdorur rrëfime të dëshmitarëve okularë** dhe burime të dorës së parë **për të luftuar informacionin e rremë** të përhapur gjerësisht. **Hulumtimi** i thelluar dhe **auditimi** i **dokumentacionit përkatës** përdoren gjithashtu si metoda për zbulimin e së vërtetës rreth temave aktuale. Programi fokusohet jo vetëm **në gazetarinë cilësore,** por edhe në **krijimin e përmbajtjes** dhe **edukimin politik**, me qëllim që **të arrijë një segment të madh** të publikut dhe **të përmirësojë aftësitë e tij të të menduarit kritik.** Ndër **sfidat kryesore** me të cilat përballet El-Shafra janë luftimi **i kufizimeve** për të drejtën e ligjshme **të aksesit në informacionin publik** dhe gjetja e **platformave** të botimit që do **të angazhojnë** efektivisht **një audiencë të re rinore** që shpesh janë në shënjestër të lajmeve të rreme dhe fushatave të dezinformimit. Të nxitur nga **pasioni** i tyre **për raportimin investigativ,** themeluesi i programit, një redaktor me më shumë se 10 vjet **përvojë** në media të ndryshme egjiptiane dhe ekipi i tij po ndërmarrin hapat e nevojshëm për t'i trajtuar këto sfida, siç dëshmohet **nga popullariteti dhe shikueshmëria e raporteve** që ata botojnë.

Çfarë ka të veçantë "El-Shafra" ?

Videot e Facebook dhe YouTube të krijuara si pjesë e programit kanë mijëra shikime dhe frymëzojnë audiencën që të mësojë më shumë rreth çështjeve të caktuara dhe të kontaktojë prezantuesin për referenca dhe burime të mëtejshme. Në këtë pikë, faqja në Facebook që mikpret raportimet e El-Shafra, ka më shumë se 6.9 milionë ndjekës.

Si ta adoptoni modelin e "El-Shafra"?

Zbuloni se cila është **superfuqia juaj** - raportimi, xhirimi i videos, intervistimi, menaxhimi i mediave sociale, analizimi dhe **krijoni ekipin me një grup ekspertësh** në të gjitha **fushat e tjera** që lidhen me zhvillimin e një **platforme mediatike bashkëkohore dhe të pavarur.** Shfrytëzoni sa më shumë **mjetet dixhitale** që keni në dispozicion dhe mos lejoni që frika e dështimit t'ju pengojë.

Mësoni më shumë :

Video Galeria e El-Shafra në Facebook

Kanali YouTube I El-Shafra

Çfarë ka të mrekullueshme "Al Qatiba" ?

Al Qatiba është një **revistë online** e specializuar **në gazetarinë investigative, gazetarinë e të dhënave** dhe rrëfimin (storytelling). Qasja e saj editoriale **ka tre parime kryesore** - **hetimin, shpjegimin dhe vizualizimin e të dhënave**, e cila ofron përmbajtje unike, angazhuese dhe **ndërvepruese**. Gjithashtu ajo publikohet në **dialektin tunizian**, duke i bërë kështu temat komplekse **të aksesueshme** për një audiencë më të madhe. Në përpjekjet e tij të përditshme, ekipi që qëndron pas revistës mbështetet nga një departament prodhimi, i cili është përgjegjës për përmbajtjen audio-vizuale, dhe një departament kërkimor, i cili ofron njohuri të rëndësishme strategjike nga sektori i medias.

Artikujt dhe **raportet** e Al Qatiba ofrojnë **një perspektivë alternative** për **çështjet** politike dhe sociale në një rajon **të larmishëm kulturor** dhe synojnë **të mbrojnë** liritë publike dhe individuale duke **luftuar** kundër **mosndëshkueshmërisë, despotizmit** dhe praktikave korruptive. Revista menaxhohet nga organizata "Taqallam for Freedom of Speech and Creativity", aktivitetet e tjera të së cilës përfshijnë:

- **Promovimi i kulturës dixhitale** dhe transformimit dixhital;
- Mbështetja dhe **promovimi i praktikave më të mira të gazetarisë investigative** dhe analizës së të dhënave;
- **Trajnimi i gazetarëve** dhe specialistëve në fushat e **rrëfimit ndërveprues (interactive storytelling) ,** design thinking**,** marketingut dhe advokimit;
- Promovimi i **përpjekjeve që sigurojnë akses** të lirë **në dokumente** dhe të dhëna publike;
- **Mbrojtja e të drejtave të pakicave;**
- Zhvillimi i **hapësirave dixhitale dhe fizike** që nxisin forma të ndryshme **të shprehjes së krijimtarisë -** dramë, filmim, shkrim, muzikë, etj.

Projekti aktual i organizatës fokusohet në zhvillimin e një **platforme** dixhitale të aksesueshme pa pagesë që ofron shpjegime **të mekanikës** së **administratës shtetërore**, parlamentit, **ekonomisë**, sistemit gjyqësor, **legjislacionit** dhe sistemit politik të Tunizisë **të bazuara në të dhëna**, **të pasura vizualisht** dhe **ndërvepruese,** për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë se si vendi i tyre funksionon dhe për të identifikuar problemet e mundshme.

Çfarë ka të veçantë "Al Qatiba" ?

Al Qatiba e vendos publikun në qendër të procesit të prodhimit të lajmeve dhe hedh dritë mbi aspekte të errëta të çështjeve urgjente të shoqërisë tuniziane. Prezantimet tërheqëse në mediat sociale kontribuan në shtrirjen e raportimeve investigative dhe i ndihmuan lexuesit të zbulojnë të vërtetën dhe të dallojnë narrativat jo të vërteta rreth temave të ndryshme.

Mjetet vizuale interaktive rezultuan të ishin mjaft ndikuese pasi i bënë grupet e mëdha të të dhënave qeveritare të kuptueshme për një audiencë të gjerë. Audienca ishte e shpejtë për të identifikuar problemet dhe për të kërkuar ndryshime.

Si mund ta adoptoni modelin e Al Qatiba?

Vendosini vetes synimin për të ofruar **informacion të besueshëm, tërheqës dhe të aksesueshëm** për publikun, në mënyrë që ky i fundit **të kuptojë** se **si funksionon vendi** dhe **të kërkojë ndryshime pozitive.**

Njohuritë praktike mund aksesohen përmes **faqes zyrtare të internetit të Al Qatiba** dhe gjatë sesioneve live me anëtarët e ekipit të Al Qatiba.

Mësoni më shumë : Faqja zyrtare e Al Qatiba

10 Nawaat: Jepi Zë Komuniteteve të Margjinalizuara dhe Mbajtja nën Kontroll e Pushtetit

Çfarë ka të mrekullueshme "Nawaat" ?

"Nawaat" është një **platformë e pavarur e medias** online tuniziane, e cila prodhon dhe publikon **lajme, hetime dhe analiza të situatave të ndryshme** duke përdorur **një sërë formatesh.** E mundësuar nga gati një mijë **kontribues** dhe një **ekip gazetarësh dhe blogerësh profesionistë,** ajo preferon **punën në terren** dhe shpesh mbështetet nga kontributet **e aktivistëve, sinjalizuesve dhe qytetarëve të përfshirë** në çështjet publike. **Gazetaria e interesit publik** të Nawaat synon **të kundërshtojë narrativën dominuese** dhe t'u **shërbejë komuniteteve të paprivilegjuara** dhe të margjinalizuara duke u fokusuar **në tema** që **rrallë mbulohen** nga mediat kryesore. Artikujt dhe raportet e publikuar **ofrojnë pikëpamje racionale dhe të paanshme** mbi zhvillimet politike, fenomenet sociale, çështjet ekonomike, shkaqet mjedisore dhe dinamikat kulturore.

Të gjithë autorët dhe kontribuesit i përmbahen **Kartës Editoriale (Editorial Charter)** - një dokument që **njeh pavarësinë e platformës** nga **interesat shtetërorë dhe komercialë,** përkushtimin **ndaj standardeve më të larta** editoriale dhe **angazhimin në kauzat e drejtësisë sociale.** Privatësia dhe e drejta e aksesit në informacion mbështeten vazhdimisht, **ndërsa çdo burim financimi pasqyrohet, paraqitet** publikisht në kohën e duhur. Ekipi i Nawaat respekton **parimet** e mëposhtme në punën e tij të përditshme:

- **Liria e shprehjes, e** mendimit dhe e informimit;
- **Besnikëria** ndaj qytetarëve;
- **Monitorimi** i pushtetit;
- **Diversiteti** dhe përfshirja.

Çfarë ka të veçantë "Nawaat" ?

Nawaat mbështet lirinë e shprehjes, por kujdeset maksimalisht për të mbrojtur grupet vulnerabël dhe për të shmangur shkaktimin e dëmeve të panevojshme. Megjithatë, ekipi i platformës do të vazhdojë të publikojë materiale që ilustrojnë paragjykimet ekzistuese në shoqëri për sa kohë që raportimi bazohet në prova dhe nuk bazohet në stereotipe apo stigma.

Përgjatë viteve, puna e Nawaat është vlerësuar me çmime të shumta:

- Çmimi Netizen, 2011;
- Çmimi EFF Pioneer, 2011;
- Çmimi Arab eContent, 2012;
- Çmimi i Medias OpenGovTn, 2012;
- Çmimi i Bashkimit Kombëtar të Gazetarëve Tunizianë për Faqen më të Mirë Interaktive, 2015;
- Çmimi Najiba Hamrouni Maghreb për Etikën e Gazetarisë, 2020.

Si mund ta adoptoni modelin e "Nawaat"?

Inkurajoni bashkëpunimet mes aktorëve të ndryshëm dhe synoni **të punoni jo vetëm** me **gazetarë,** por edhe me **blogerë, aktivistë dhe qytetarë. Merrni frymëzim** prej tyre për temat që duhen trajtuar. **Krijimi i udhëzuesve** për autorët dhe pjesëmarrësit në iniciativë, në formën e një Karte Editoriale ose një dokumenti të ngjashëm, **është thelbësor** për ruajtjen **e integritetit. Udhëzues** të tillë duhet gjithashtu **të rishikohen** shpesh për **t'u siguruar** që ato **janë në përputhje** me **objektivat** aktuale të organizatës.

Njohuritë praktike mund të aksesohen përmes **faqes së internetit të Nawaat** dhe gjatë sesioneve në transmetim live me anëtarët e ekipit të Nawaat.

Mësoni më shumë : Faaja zyrtare e Nawaat

11 Inkyfada: Angazhimi në Ofrimin Online të Gazetarisë Investigative Cilësore

inkyfada

Çfarë ka të mrekullueshme "Inkyfada" ?

"Inkyfada" është një **grup mediatik i pavarur, jofitimprurës** i themeluar në vitin 2014 dhe me qendër në Tunis, Tunizi. Ai u krijua nga **një ekip gazetarësh, zhvillues dhe dizajnera grafikë**, me qëllim **mbështetjen e interesit publik përmes përmbajtjeve gazetareske inovative.** Përpjekjet e ekipit adresojnë nevojën në rritje për artikuj dhe lajme që përqendrohen në çështjet që prekin jetën e njerëzve pas Revolucionit Tunizian në 2011, i cili vendosi lirinë e shprehjes në plan të parë, por edhe nxorri në pah "talk shows" dhe opinione të pashkruara.

Inkyfada mori një rol si **një palë që kundërpërgjigjet ndaj padrejtësive** që rrjedhin **nga korrupsioni dhe mosndëshkimi i pushteteve.** Ajo përpiqet të vendosë **standardet për raportim me cilësi të lartë** dhe të orientuar drejt drejtësisë në një peizazh mediatik të përmbytur me narrativa jo të plota dhe të njëanshme. I përkushtuar për të zbuluar informacione të fshehura nga publiku i gjerë, ekipi i Inkyfada sjell gjetje të reja kundër prapaskenave që kanë rëndësi dhe i prezanton **ato në forma vizuale ose audio të lehta për t'u kuptuar dhe shpesh ndërvepruese.** Përmbajtja gazetareske krijohet nëpërmjet një **bashkëpunimi të vazhdueshëm** të departamenteve editoriale, të kërkimit dhe zhvillimit dhe të dizajnit. Mjete të ndryshme mediatike dhe teknologjike **përdoren për të ndarë histori individuale dhe reportazhe investigative** në një mënyrë të menduar paraprakisht, **të kuptueshme dhe fuqizuese.** Si rezultat, audienca mund të zgjedhë si nga artikujt e gjatë, artikujt shpjegues, rrëfimet e ilustruara, hartat ndërvepruese, ashtu edhe nga dokumentarët në formë audio dhe video, eset të ilustruara me foto, podkastet dhe më shumë.

Me një fokus të veçantë në hetimin, kontekstualizimin dhe vizualizimin e të dhënave, përmbajtja e Inkyfada i **ndihmon njerëzit të kuptojnë** dhe të përfshihen në **politikat që ndikojnë** në jetën e tyre. Për më tepër, Inkyfada promovon lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes, ofron informacion të pavarur dhe të dobishëm për qytetarët dhe **kontribuon në rivendosjen e marrëdhënieve midis krijuesve** të përmbajtjes informative dhe qytetarëve. Për më tepër, grupi zhvillon mjete teknologjike që lehtësojnë pjesëmarrjen e **qytetarëve** dhe aksesin në materiale edukative rreth mediave dhe teknikave për prodhimin e përmbajtjes informative.

Çfarë ka të veçantë "Inkyfada" ?

Inkyfada përdor teknologjinë, inovacionin dhe kreativitetin për të prodhuar lajme në një mënyrë tërheqëse. Organizata kryen hetime dhe publikon histori rreth temave të shumta shoqërore: kufijtë dhe migracioni, politika e Tunizisë, dhuna me bazë gjinore, bujqësia dhe ushqimet, të drejtat dhe liritë, aksesi në kujdesin shëndetësor dhe sfidat mjedisore. Gjithashtu janë shpërndarë edhe artikuj shpjegues ose kontekstualistë që ofrojnë përgjigje më të thjeshta për pyetje të ndryshme.

Për më tepër, si një avokat i rrëfimit gjithëpërfshirës, Inkyfada ishte grupi i parë mediatik në Tunizi që shkroi ekskluzivisht me gjuhë të ndjeshme gjinore në versionin francez të platformës së saj.

Stafi redaktues dhe departamenti i R&D (Kërkim dhe Zhvillim) (InkyLab) bashkë-dizajnuan **instrumentin inku.be** - një platformë botuese që u mundëson gazetarëve të integrojnë në mënyrë të pavarur përmbajtjen multimediale në mediat e tyre online. Kjo platformë është ndërtuar për të akomoduar lloje të ndryshme dhe gjithnjë në zhvillim të përmbajtjeve gazetareske. Inku.be është bërë një komponent integral i modelit të biznesit të Inkyfada dhe është adoptuar nga redaktorët online në mbarë botën.

Si mund ta adoptoni modelin e "Inkyfada" ?

Shkurtimisht - **përdorni të gjitha burimet krijuese dhe teknologjike** që keni në dispozicion. Ofrimi i lajmeve dhe hetimeve në një mënyrë tërheqëse e bën më të lehtë për lexuesit kur marrin informacionin në ekranet e tyre. Pra, nëse do të filloni të publikoni në internet, sigurohuni që **të grumbulloni një ekip të shkathët profesionistësh me ekspertizë në fusha të ndryshme** - dizajner grafik, zhvillues, studiues, analistë të dhënash, redaktues të videove, projektues grafik.

Njohuritë praktike mund të aksesohen nëpërmjet **faqes së internetit të Inkyfada** dhe gjatë sesioneve në transmetimin live me anëtarët e ekipit të Inkyfada.

Mësoni më shumë :

Faqja zyrtare e Inkyfada

Njohuri rreth këtij shembulli



Shembuj Konkretë të Gazetarisë Qytetare
Platformat e Verifikimit të Fakteve

1 **Faktoje:** Verifikimi i Fakteve si Mjet për të Luftuar Dezinformimin

Faktoje.al

Çfarë ka të mrekullueshme "Faktoje" ?

"Faktoje" është një **shërbim mediatik shqiptar i verifikimit të fakteve** që promovon **llogaridhënien** bazuar **në të drejtën për informim dhe transparencë.** Kontrolli i fakteve ose verifikimi i fakteve është **një kategori moderne, e identifikueshme e gazetarisë.** Ai synon të sigurojë një analizë të saktë dhe të paanshme të deklaratave publike **për të korrigjuar keqkuptimet dhe për të rritur njohuritë e publikut** mbi çështje të rëndësishme. Mediat sociale kanë zgjeruar burimet e informacionit dhe si rrjedhojë ndërtimin e narrativave, gjithashtu kanë minuar rolin e gazetarëve si tregues të së vërtetës. Kjo është arsyeja përse verifikimi i fakteve është shumë i rëndësishëm, ai mund të ndikojë në publik dhe të mobilizojë opinionet politike. **Ekipi** i Faktoje përbëhet **nga redaktorë dhe gazetarë**, të cilët fokusohen **në verifikimin e deklaratave, premtimeve dhe veprimeve** të zyrtarëve publikë dhe institucioneve kryesore në vend. Në punën e tyre të përditshme të gjithë anëtarët e ekipit u përmbahen parimeve të mëposhtme:

- **Paanshmëria dhe integriteti:** As stafi dhe as kontribuesit nuk janë të lidhur me ndonjë parti politike, zyrtar apo kandidat. Redaktorët nuk mbajnë anë në debatet politike për asnjë çështje, përveç se u bazohen transparencës, saktësisë dhe integritetit të informacionit. Deklaratat dhe premtimet e politikanëve, zyrtarëve publikë dhe subjekteve që përfitojnë nga fondet publike për t'u verifikuar, janë përzgjedhur në bazë të ndikimit që kanë në jetën e qytetarëve. Kontrolli i fakteve kryhet sipas një metodologjie, e cila është përshkruar në seksionin "Rreth nesh" të faqes zyrtare të platformës. Faktoje synon ruajtjen e ekuilibrit dhe verifikimin e deklaratave dhe premtimeve të përfaqësuesve të sferës politike (qeverisë dhe opozitës) dhe institucioneve të tjera publike. Përfundimet e nxjerra bazohen në prova gjatë gjithë kohës. Që nga themelimi i saj, punonjësve aktualë dhe të ardhshëm të Faktoje u kërkohet të mos merren me aktivitete politike.

- **Pavarësia editoriale:** Financuesit nuk luajnë asnjë rol në zgjedhjen e pretendimeve që kontrollon platforma dhe nuk kanë asnjë ndikim mbi mënyrën se si kryhet puna. Vetëm Faktoje.al ka përgjegjësi të plotë për të gjitha vendimet editoriale. Ekipi verifikon çdo pretendim në mënyrë të barabartë - pavarësisht nëse ato mund të

mbivendosen apo jo me interesat e financuesve.

Faktoje ka qenë pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve (IFCN) si anëtar nënshkrues që nga janari 2020 dhe pjesë e rrjetit kundër dezinformimit në Ballkan që nga prilli 2020. Organizata është gjithashtu partneri i besuar për Shqipërinë për një program verifikimi të lajmeve të rreme të platformave "Meta".

Çfarë ka të veçantë "Faktoje" ?


Ndikimi i punës së **"Faktoje"** nuk shtrihet vetëm tek publiku shqiptar, por edhe ai i Ballkanit Perëndimor, pasi Faktoje është përfshirë në disa projekte që kanë në fokus luftën kundër dezinformimit dhe lajmeve të rreme. Për më tepër, anëtarët e ekipit të organizatës kanë trajnuar 300 të rinj në 9 zona të vendit për edukimin mbi median, metodologjitë e verifikimit të fakteve dhe teknikat për të dalluar lajmet e rreme, si dhe kanë marrë pjesë në lëndën e "Verifikimit të Fakteve" në ofruar nga Departamenti i Gazetarisë pranë Universitetit të Tiranës. Faktoje trajnon çdo vit një rrjet prej mbi 30 gazetarësh lokalë në 15 qytete.

Si mund ta adoptoni modelin e "Faktoje" ?

Përpara se të filloni të ndërtoni një faqe mbi verifikimin e fakteve (fact-checking), është më mirë të **eksploroni mënyrat e funksionimit dhe metodologjinë e tyre** në faqen e internetit të ICFN. Një nga **procedurat që ndjek ekipi i Faktoje** gjatë punës së tij është paraqitur mëposhtë:

Të gjitha pretendimet e mundshme merren në konsideratë së pari në mbledhjet editoriale. Diskutimi përfshin konflikte të mundshme, qasjet më të mira gazetareske ndaj çështjes, gjetjen e informacionit dhe caktimin e një gazetari për të punuar mbi temën. Gazetari diskuton me redaktorin burimet, ekspertët, materialet vizuale dhe strukturën e përgjithshme të artikullit. Pasi gazetari përfundon artikullin, redaktori e shqyrton tekstin për qartësi dhe saktësi përpara se të japë një dritë jeshile për botim.

Mësoni më shumë: Faqja zyrtare e Faktoje në gjuhën Angleze



2 **Faktograf:** Nxitja e Partneriteteve Ndërkombëtare për Verifikimin e Fakteve për të Arritur një Audiencë më të Gjerë

Çfarë ka të mrekullueshme "Faktograf"?

Faktograf – Shoqata për Publikun e Informuar (Association for the Informed Public) është botuesi i portalit Faktograf.hr, i vetmi medium në Kroaci që është i **specializuar në verifikimin e fakteve**. Qëllimi i Faktograf.hr është **të vlerësojë saktësinë dhe vlefshmërinë** e **deklaratave** të politikanëve kroatë, si **dhe të aktorëve të tjerë të politikës, publikisht të rëndësishëm** dhe të **parandalojë që një qëndrim i pabazuar,** i deklaruar mjaft herë në diskursin publik, **të fitojë statusin e faktit.** Ekipi që qëndron pas portalit përpiqet të **kundërshtojë dezinformimin** në hapësirën publike dhe të zhvillojë një hapësirë përkatëse mediatike jofitimprurëse ku **jeta politike** në Kroaci të **mbulohet nga gazetaria profesionale dhe etike, pa ndikimin e interesave** të ndryshme dhe të veçanta.

Faktograf nënshkroi Kodin e Përforcuar të Praktikës mbi Dezinformimin në qershor 2022 dhe është anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve (IFCN), Rrjetit Evropian të Standardeve të Verifikimit të Fakteve (EFCSN) dhe Programit të Verifikimit të Fakteve nga Pala e Tretë e "Meta"s. Në nivel rajonal shoqata është një nga anëtarët themelues të SEE Check – rrjeti prej 6 organizatash nga 5 vende të Evropës Juglindore që punojnë në promovimin e llogaridhënies mediatike, përmirësimin e edukimit mediatik dhe luftimin e çinformimit dhe dezinformimit.

Në punën e tyre të përditshme, gazetarët dhe redaktorët e Faktograf.hr u përmbahen parimeve dhe politikave të mëposhtme:

- **Nuk janë partiakë dhe promovojnë Drejtësi**
- **Ruajnë Standardet dhe Transparencen e Burimeve**
- **Transparenca e Financimit dhe Organizimit**
- **Standardi dhe Transparenca e Metodologjisë**
- **Politika për Korrigjime të Hapura dhe të Ndershme**

Çfarë ka të veçantë "Faktograf"?

Faktograf zgjedh temat duke ndjekur raportimet e mediave dhe diskutimet publike në rrjetet sociale dhe përpiqet t'u përgjigjet sa më shumë pyetjeve të lexuesve. Prioritet janë temat me interes publik dhe fushatat keqinformuese që rrezikojnë shëndetin publik ose shërbejnë për të manipuluar proceset zgjedhore. Gjatë verifikimit dhe vlerësimit të saktësisë, ekipi i Faktograf.hr përdor këto lloje burimesh: burime zyrtare (të dhëna dhe njoftime të institucioneve publike dhe autoriteteve të tjera publike), kërkime shkencore, të dhëna nga shoqëria civile dhe organizata ndërkombëtare, opinione të ekspertëve përkatës dhe burime mediatike. Gjithashtu ata përdorin mjete dixhitale për të gjurmuar burimet dhe verifikuar të dhënat. Informacionet nga burime anonime dhe të pagjurmueshme nuk merren parasysh.

Si mund ta adoptoni modelin e "Faktograf"?

Filloni duke shfletuar faqet e tjera të internetit **të krijuara** tashmë **për verifikimin e fakteve** - për shembull PolitiFact, FactCheck dhe The Washington Post Fact Checker ishin modele për iniciativën e Faktograf. Një **rishikim i praktikave më të mira** do t'i ndihmojë krijuesit **të vlerësojnë se çfarë nevojitet** për të ofruar **informacion objektiv dhe etik** për publikun. Për më tepër, **kërkimi i ndihmës nga organizatat që verifikojnë faktet** në të gjithë rajonin, do të lehtësonte procesin e zbatimit. Së fundi, **të qënit transparent me lexuesit** është një faktor kyç për të patur sukses.

Për shembull, redaksitë që përbëjnë rrjetin rajonal SEE Check kanë informuar publikun çdo ditë për dezinformatat më të fundit në rajon që nga fillimi i pushtimit rus duke përdorur një blog të përbashkët Live blog rreth luftës në Ukrainë. **Bashkëpunimi ndërkufitar** dhe **shkëmbimi i njohurive** është çelësi i suksesit të SEE Check si rrjet.

Mësoni më shumë:

Portali I Faktograf

Kodi i Parimeve të IFCN

3 **Demagog:** Verifikimi i Fakteve për të Mbrojtur Publikun nga Dezinformatat e Dëmshme

Çfarë ka të mrekullueshme "Demagog"?

Shoqata Demagog është **organizata e parë e verifikimit të fakteve** në Poloni dhe anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve (IFN). Qëllimi kryesor i Shoqatës është t**ë përmirësojë cilësinë e debatit publik** duke u ofruar **qytetarëve informacion të paanshëm dhe të besueshëm.** E udhëhequr nga parimet **e sinqeritetit, apoliticitetit, objektivitetit dhe profesionalizmit,** ekipi që qëndron pas Demagogut **verifikon deklaratat dhe premtimet** e politikanëve në faqen e tyre që nga viti 2014.

Shoqata gjithashtu përhap idenë e verifikimit të fakteve në Poloni. Në kuadër të luftës kundër lajmeve të rreme, Demagog **zhvillon seminare** dhe realizon **projekte edukative** që targetojnë **të rinjtë,** si **Akademia e Verifikimit të Fakteve.**

Misioni i Demagogut është t'u sigurojë **qytetarëve** akses në **informacione të besueshme, të ndryshme dhe të paanshme** rreth **politikës, gazetarisë dhe shkencës.** Shoqata aspiron **të luftojë lajmet e rreme** dhe **dezinformimim** dhe të rrisë cilësinë e debatit publik. Duke bërë këtë, Demagogu bëhet urë edhe për krijimin e një shoqërie që merr **vendime të bazuara në fakte**.

Çfarë ka të veçantë "Demagog" ?

Punonjësit e Demagog përdorin mjete të ndryshme për të monitoruar informacionin e shpërndarë në publik. Deklaratat e bëra nga politikanët verifikohen

duke përdorur një qasje cilësore të ndarë në katër hapa: kampionimi i deklaratave, verifikimi i informacionit duke përdorur burime publike, vlerësimi i çdo deklarate dhe, nëse është e nevojshme, korrigjimi i gabimeve pas publikimit. Prandaj Demagogu jo vetëm që i korrigjon politikanët, por edhe i tregon gabimet e tyre dhe i mëson qytetarët se si të jenë kritikë kur informohen përmes mediave. Aktivitete të tjera konsistojnë në mbështetjen dhe edukimin e qytetarëve për përfshirjen e tyre të mundshme në lëvizjet lokale dhe organizatat ndërkombëtare si BE. Përveç kësaj, Demagog po zhvillon më tej metoda të verifikimit të fakteve, duke krijuar aktivitete mbikëqyrëse dhe duke mbështetur mbrojtjen e të drejtave civile. Akademia e Verifikimit të Fakteve ka për qëllim edukimin e më shumë se 4,000 personave mbi çështjet e dezinformimit dhe lajmeve të rreme përmes seminareve të ndryshme.

Në përgjithësi, Shoqata Demagog dhe projektet e saj kanë pasur një ndikim të dukshëm në Poloni. Kjo u bë veçanërisht e dukshme gjatë zgjedhjeve, pandemisë Covid-19 dhe luftës në Ukrainë. Përveç kësaj, Demagog i është bashkuar programit të verifikimit të fakteve të Facebook së bashku me më shumë se 50 organizata të tjera të pavarura, gjë që e bëri më të lehtë për ekipin të gjurmonte dhe të demaskonte keqinformimin e përhapur nëpër mediat sociale.

- **Si mund ta adoptoni modelin e Demagog ?**

Lufta ndaj ndikimit të rrezikshëm të lajmeve të rreme dhe aksesi i qytetarëve në fakte, është diçka ku çdo shtet duhet të fokusohet. Ekipi i Demagogut përdor **burime publike** për të përmbushur këto qëllime. I njëjti lloj informacioni ka shumë të ngjarë të **disponohet pa pagesë** në vende të tjera, duke e bërë të lehtë adoptimin e modelit. **Krijimi i një komuniteti** që **mban përgjegjësi** për veten dhe të tjerët është çelësi i suksesit të një organizate të tillë jofitimprurëse, pasi **vendos standarde më të larta mbi lajmet** në mendjen e qytetarëve.

- **Mëso më shumë:**

Faqja zyrtare e Demagog

Intervistë me një nga redaktorët e Demagog

Artikull mbi përfshirjen e Demagog në programin e verifikimit të fakteve të Facebook



4 Factcheck.Bg: Mbështetja e Gazetarëve dhe Publikut me Informacion të Verifikuar mbi Çështjet Kryesore

Çfarë ka Factcheck.bg të mrekullueshme?

Factcheck.bg është e vetmja **platformë web** në Bullgari e **dedikuar vetëm për verifikimin e fakteve**, një nismë e Shoqatës së Gazetarëve Evropianë-Bullgari (AEJ). Në maj të vitit 2021, Shoqata mblodhi **një ekip gazetarësh profesionistë, jopartiakë për të kundërshtuar** ndotjen në rritje të mjedisit informativ të Bullgarisë **nga çinformimi dhe dezinformimi**. Objektivi i projektit është të **kontrollojë pretendimet** mbi **temat me interes publik** me **ndikim të mundshëm social,** bazuar në **standarde më të larta të gazetarisë profesionale**. Për të maksimizuar ndikimin, projekti fokusohet në **ndihmën e gazetarëve bullgarë** për të dalluar **faktet nga falsifikimi** në **mediat sociale,** mediat tradicionale, **deklaratat publike** të zyrtarëve dhe në burime të tjera informacioni. **Artikujt** në këtë faqe synojnë gjithashtu **të informojnë qytetarët bullgarë,** të cilët janë të interesuar **për lajmet dhe çështjet publike** dhe kërkojnë përgjigje **për pyetje të tjera me rëndësi sociale.**

Factcheck.bg synon **të ndihmojë** publikun të bëjë **zgjedhjet e tij të informuara për çështje të rëndësishme** si **zgjedhjet** e liderëve politikë, **shëndeti publik** gjatë një pandemie globale dhe respektimi i detyrimeve **ndaj të drejtave të njeriut. Vendimet** se cilat pretendime duhen kontrolluar, si duhet të kontrollohen dhe si shkruhen verifikimet e fakteve, **merren bashkërisht nga gazetarët** dhe **redaktori**.

Parimet kryesore që drejtojnë Fackcheck.bg janë:

- **Paanshmëria dhe integriteti:** Ekipi është plotësisht jopartiak dhe as stafi, as kontribuesit nuk janë të lidhur me ndonjë parti politike, zyrtar apo kandidat. Ata përdorin vigjilencë të vazhdueshme për të ruajtur paanshmërinë dhe për të shmangur favorizimin e e ndonjë krahu në çdo çështje.
- **Pavarësia Editoriale:** Vetëm Factcheck.bg ka përgjegjësi të plotë për të gjitha vendimet editoriale. Ekipi verifikon çdo pretendim në mënyrë të barabartë - pavarësisht nëse ato mund të mbivendosen apo jo me interesat e financuesve.
- **Transparenca e Metodologjisë:** Ekipi u jep përparësi pretendimeve që ata kontrollojnë bazuar në kombinimin e tre faktorëve: duken të dyshimtë në sipërfaqe; kanë një ndikim të rëndësishëm të mundshëm social për shkak të temës ose pozicionit ose ndikimit publik të folësive; arrijnë një audiencë të gjerë bazuar në shtrirjen në mediat sociale ose në madhësinë e tregut të televizionit, radios ose medias së shkruar.

Çfarë ka të veçantë “Factcheck.bg” ?

Factcheck.bg mbështet përpjekjet e gazetarëve bullgarë për t'i ofruar audiencës mediatike informacion cilësor duke kontrolluar pretendimet e bëra nga zyrtarët në mediat sociale, mediat tradicionale dhe deklaratat publike. Duke ofruar informacion të

verifikuar dhe të besueshëm për tema të cilat janë objektiva të shpeshta të fushatave dezinformuese, platforma gjithashtu vepron si një burim informacioni për qytetarët e interesuar për lajmet dhe çështjet publike, dhe ata që kërkojnë përgjigje për pyetje të tjera me rëndësi sociale.

- **Si mund ta adoptoni modelin e Factcheck.bg?**

Në kuadër të projektit "**Verifikimi i fakteve: Krijimi i komunitetit"**, të zbatuar nga Shoqata e Gazetarëve Evropianë-Bullgari, u krijua **një udhëzues për verifikimin e fakteve** në **mjedisin dixhital, i cili mund të aksesohet** këtu.

- **Mësoni më shumë:**

Platforma Factcheck.bg

Shoqata e Gazetarëve Evropianë - Faqja e internetit e Bullgarisë

5 **Ellinika Hoaxes:** Veprime Komunitare kundër Lajmeve të Rreme dhe Përmbajtjes së Manipuluar në Internet

- **Çfarë ka të mrekullueshme "Ellenika Hoaxes" ?**

Ellinika Hoaxes (Hellenic Hoaxes) u themelua në vitin 2013 në Greqi **si portali i parë në internet që koordinon përpjekjet për të verifikuar** vërtetësinë **e lajmeve** dhe **pretendimeve që qarkullojnë në media** dhe **rrjetet sociale**. Ekipi redaktues që qëndron pas projektit përbëhet nga **profesionistë** me përvojë në **identifikimin dhe zhbërjen e miteve,** lajmeve të rreme, **videove të rreme, fotove të manipuluara** dhe **mashtrimeve të tjera** të përhapura **në internet**. **Mjetet** kryesore të përdorura nga ekipi përfshijnë **kërkimin, mbledhjen e të dhënave nga burime të besueshme** dhe **vlerësimin** e të dhënave. Duke qenë se një detyrë e caktuar mund të variojë nga kontrollimi i një imazhi për të zbuluar nëse është i redaktuar apo jo, tek kontrollimi i pretendimeve pseudo-mjekësore, apo edhe verifikimi dhe shpjegimi i një projektligji, nuk ka asnjë metodologji të vetme që është e përshtatshme për të gjitha rastet. Në bazë javore, **disa dhjetëra deri në qindra kërkesa** pranohen **për verifikimin e fakteve,** qoftë përmes mesazheve në faqen e Facebook ose në një grup të dedikuar në Facebook. Ky i fundit është krijuar me qëllimin kryesor **për të edukuar përdoruesit mbi mënyrat e verifikimit të pretendimeve** dhe drejtohet nga anëtarët e ekipit. Disa pretendime nuk mund të verifikohen menjëherë ose verifikohen në të ardhmen pasi të jenë të disponueshme provat e nevojshme. **Prioritet** u jepet **kërkesave nga ndjekësit** e faqes, **keqinformimeve të shpërndara gjerësisht** mbi **tema sensitive** dhe **pretendimeve që targetojnë** individë të veçantë dhe **grupe vulnerabël.**

Ellinika Hoaxes i nënshtrohet auditimeve vjetore **mbi transparencën, paanësinë dhe sponsorizimin,** nuk **ka lidhje me asnjë** media dhe **kontribuon** rregullisht në **Programin e Verifikimit të Fakteve të Palëve të Treta të Meta-s.** Përveç kësaj, portali është **anëtar** i **Observatorit Evropian të Mediave Dixhitale** dhe **Rrjetit Ndërkombëtar të Verifikimit të Fakteve.**

Çfarë ka të veçantë "Ellinika Hoaxes" ?

Ellinika Hoaxes është shpesh një pikë referimi në shkrimet vendase për shkak të besueshmërisë së portalit në ndërlidhjen e lajmeve. Anëtarët e ekipit të Ellinika Hoaxes janë ftuar shumë herë në emisione televizive dhe radiofonike për të folur mbi fenomenin e lajmeve të rreme dhe mënyrat e trajtimit të tij. Madje në parlament janë diskutuar disa publikime që ndodhen në faqen e tyre të internetit.

Aktualisht Ellinika Hoaxes po hedh hapin tjetër të madh në luftën kundër lajmeve të rreme duke krijuar browser extension e parë grek, i cili paralajmëron lexuesit në kohë reale se sa i besueshëm është faqja që ata po vizitojnë. Ai shfaq një paralajmërim specifik në varësi të kategorisë së besueshmërisë në të cilën ndodhet faqja e internetit: satirë, teori konspirative, pseudoshkencë, informim i rremë, clickbait (klikim karrem) dhe retorikë urrejtjeje.

Si mund ta adoptoni modelin e Ellinika Hoaxes?

Kur krijoni një portal për verifikimin e fakteve, përfshini **ekspertë nga sa më shumë fusha** të jetë e mundur dhe **jepini përparësi sugjerimeve** të lexuesve për pretendimet që do të hetohen. **Analizoni në mënyrë proaktive deklaratat virale** dhe **pjesët e informacionit që mund të kenë pasoja të dëmshme, të shqetësojnë shëndetin publik, çështjet aktuale** ose **minojnë proceset demokratike** dhe vlerat njerëzore.

Mësoni më shumë : Faqja zyrtare e Ellinika Hoaxes

6 Fatabyyano: Kundër Dezinformimit në Lindjen e Mesme përmes Angazhimit Online

Çfarë ka të mrekullueshme "Fatabyyano" ?

Fatabyyano është një platformë e **pavarur** arabe e **verifikimit të fakteve,** e themeluar nga YouTuber-i 25-vjeçar dhe studenti i mjekësisë Dr. Moath Al Taher me qëllim **luftimin e lajmeve të rreme** dhe dezinformatave dhe **edukimin e një brezi të ri qytetarësh** aktivë me **aftësi kritike më të larta.** Platforma **mbulon 20 vende** në **Lindjen e Mesme të përfshirë nga konflikti**, ku përdoruesit e internetit janë të ekspozuar çdo ditë **ndaj valëve të mëdha të lajmeve** dhe ofron **informacion të besueshëm në 6 gjuhë të ndryshme** përveç arabishtes. Kjo e fundit është e mundur falë përpjekjeve të një **ekipi ekspertësh, studiuesish, akademikësh, profesionistësh të medias** dhe **zhvilluesve të web-it** ndër të tjerë. Punonjësit dhe praktikantët e Fatabyyano **nuk kanë lidhje politike** dhe respektojnë **parimet e mëposhtme:**

- Drejtësia dhe Paanshmëria;
- Standardet e larta Profesionale dhe Transparenca e Burimeve;
- Transparenca e Financimit dhe Organizimit;
- Standardet dhe Transparenca e Metodologjisë;
- Politika për Korrigjime Transparente dhe të Ndershme.

Pavarësisht nga konteksti politik dhe socio-ekonomik, platforma synon të nxjerrë në pah **pasojat e rrezikshme të lajmeve të rreme** (gjuha e urrejtjes, dhuna partiake) dhe rëndësinë e zhvillimit të një mentaliteti **të të menduarit kritik** dhe **verifikimit të vërtetësisë** së përmbajtjes **përpara se të shpërndahet**. Fatabyyano është **një partner i vlerësuar rajonal** i **Programit të Verifikimit të Fakteve të Palëve të Treta të Meta-s** dhe punon **për të përmirësuar cilësinë e lajmeve në Facebook** duke ndjekur dhe zbatuar hapat **për rishikimin dhe vlerësimin e saktësisë** së historive, përfshirë fotot dhe videot që shfaqen në burimet e lajmeve të përdoruesve.



- **Çfarë ka të veçantë "Fatabyyano" ?**

Fatabyyano ka një total prej më shumë se 1 000 000 ndjekës që flasin arabisht nëpër kanale të ndryshme të mediave sociale. Shfaqjet video të platformës janë përkthyer në 6 gjuhë, janë ndjekur nga 500 000 njerëz dhe kanë gjeneruar 4 000 000 shikime deri më tani. Aktualisht, redaksia po prodhon një emision të ri të quajtur Fatabyyano TOON, i cili i kushtohet audiencës më të re në moshë dhe përbëhet nga më shumë se 10 episode.

- **Si mund ta adoptoni modelin e "Fatabyyano"?**


Krijimi **i një komuniteti ndërveprues profesionistësh** (studiues, analistë të dhënash, zhvillues, gazetarë, menaxherë të mediave sociale) luan **një rol kyç** kur bëhet fjalë **për transferimin** dhe përhapjen **e praktikave të mira të verifikimit të fakteve dhe hartimin e udhëzuesve dhe instrumentave miqësorë** për përdoruesit **për verifikimin** e origjinalitetit dhe të vërtetës së informacionit dhe lajmeve të shpërndara gjerësisht.

- **Mësoni më shumë:**

[Faqja zyrtare e Fatabyyano]

[Conseils de journalistes mbi Fatabyyano]

[Artikull rreth Fatabyyano në Daily News Egjipt]





1 Edukimi Mediatik dhe Informativ: Edukimi rinor për një Audience të Përgjegjshme dhe Kritike

Çfarë ka të mrekullueshme ?

Synimi i projektit është **të përmirësojë aftësitë e të rinjve mbi Edukimin Mediatik dhe Informativ (MIL)** përmes futjes së MIL në **sistemin arsimor formal** në Shqipëri. Për ta bërë këtë të ndodhë, është ndjekur një proces gjithëpërfshirës hap pas hapi. Procesi rezultoi **në përshtatjen e kurrikulave në 20 shkolla dhe hartimin e moduleve të trajnimit të mësuesve;** trajnimi i trajnerëve; trajnimi i mësuesve; trajnimi i mentorëve dhe pilotimi i moduleve MIL në të gjitha lëndët e arsimit parauniversitar.

240 mësues janë trajnuar për përdorimin e kurrikulës MIL në klasa në tre faza: a) si **metodologji për të aksesuar informacionin**; b) si një metodologji **për të përmirësuar aftësitë e të menduarit kritik** tek nxënësit; c) si një metodologji **për të stimuluar krijimin** e kontentit dhe shprehive midis nxënësve .

Projekti erdhi si një **përgjigje** ndaj transformimit të shpejtë dixhital dhe avancimit të çrregullimeve të informacionit, të karakterizuara nga një rënie në respektimin e standardeve gazetareske, **përhapje të dezinformatave** dhe **rënie** e **besimit** të shoqërisë ndaj **medias**. Parimet e ndjekura gjatë gjithë zbatimit të projektit në Shqipëri **janë gjithëpërfshirja dhe diversiteti** - janë të përfshirë pale të interesuara në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mbulohen një gamë e gjerë temash.

Çfarë ka të veçantë ?

Rreth 9,828 nxënës nga 20 shkolla në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Lezhë kanë përfituar nga Projekti dhe kanë fituar më shumë njohuri në fushën e MIL. Rezultatet e një vlerësimi të jashtëm nga studiues të pavarur, tregojnë si më poshtë:

- **97.1%** e mësuesve pranojnë se mentorimi ka qenë i dobishëm për të kuptuar më mirë integrimin e Edukimit mbi Median dhe Informacionin (MIL) në kurrikulë;
- **50.6%** e mësimdhënësve konfirmojnë se trajnimet MIL duhet t'u ofrohen të gjithë mësuesve;
- **52%** e nxënësve e shohin MIL-in shumë të rëndësishëm për arsimimin e tyre;
- **46%** e nxënësve konfirmojnë se MIL i ka ndihmuar në jetën e përditshme, dhe **38%** në lëndët akademike.

Përdorimi i teknologjisë në klasë është një nxitje që nxënësit të përfshihen dhe të angazhohen më shumë në krahasim me rastet kur përdoren format tradicionale të mësimdhënies.

Si mund ta adoptoni modelin?

Para së gjithash, njihni **kontekstin lokal**, **vlerësoni nevojat e grupit të synuar** dhe përpiquni të **hartoni ndërhyrjen** duke pasur parasysh këto nevoja. **Përfshini përfituesit** në çdo hap të procesit. **Angazhoni** sa më shumë **palë të interesuara,** të rëndësishme për iniciativën. Kini parasysh se **investimet afatgjata në infrastrukturën e shkollave** dhe **laboratorët për median** (të pajisura me kompjuterë, projektorë, akses në internet, një bibliotekë me titujt përkatës, audio dhe video projektorë, etj.) janë të domosdoshme. **Mbani një rrjet trajnerësh** në mënyrë që **njohuritë** dhe përvoja e projektit **të mund të transferohen lehtësisht** tek **partnerët** e rinj.

Mësoni më shumë:

Faqja e projektit (midis materialeve të tjera kjo faqe përmban dokumente mbi MIL, module trajnimi për mësues, burime të lidhura me MIL dhe kurse online nga IREX dhe CFI)

Kuadri I Inicitativës

Artikulli i AMI mbi integrimin e MIL në programet arsimore

2 Manuali me Burime të Hapura (Open Source Handbook): Fuqizimi i Gazetarëve për të Prodhuar Përmbajtje Mahnitëse



Çfarë ka të mrekullueshme ?

Projekti fokusohet **në mbështetjen dhe rritjen e aftësive** të gazetarëve dhe mediave nga pikëpamja **teknike dhe teknologjike**, fushë në të cilën janë zbuluar mangësi të konsiderueshme gjatë viteve të fundit në rajonin arab. Këto mangësi kanë ndikuar në zhvillimin e organizatave mediatike, të gazetarëve dhe në konkurrueshmnërinë e tyre në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu, është ndikuar negativisht edhe cilësia e përmbajtjes mediatike.

Prandaj, qëllimi kryesor ishte krijimi i një **mundësie të re për profesionistët** dhe **institucionet** e **medias për të përfituar nga teknologjitë** në zhvillimin dhe **përmirësimin e përmbajtjes** në mënyrë që të arrihet qëndrueshmëri dhe të rriten të ardhurat e gazetarëve arabë. Të gjitha aktivitetet e projektit i shërbejnë vizionit të mëposhtëm: "T'i bëjë gazetarët dhe institucionet arabe të aftë **për të konkurruar globalisht** në aspektin **e zhvillimit, kreativitetit dhe cilësisë së përmbajtjes".**

Përveç organizimit **të seminareve të avancuara** që **mbështesin drejtpërdrejt**

gazetarët dhe **institucionet** dhe **u ofrojnë atyre zgjidhje novatore** për probleme të ndryshme, ekipi i projektit **përshtat mjete dhe baza të dhënash të dobishme në gjuhën arabe** dhe bashkëpunon me kompani private **për t'u dhënë gazetarëve akses falas në versionet me pagesë** të **softuereve** përkatës. **Vëmendje** e veçantë i kushtohet qasjeve dhe instrumenteve **për forcimin e sigurisë dixhitale** dhe **ruajtjen e privatësisë në internet.**

Iniciativat e ardhshme përfshijnë ndërtimin e një motor kërkimi për verifikimin e fakteve dhe krijimin e një pakete të re mjetesh që do t'i ndihmojë gazetarët të marrin të dhëna të vlefshme dhe të gjurmojnë lëvizjet e fondeve të dyshimta dhe të kompanive guaskë.

Çfarë ka të veçantë ?

Më shumë se 100 sesione trajnimi falas janë zhvilluar për gazetarë meshkuj dhe femra, si dhe për institucione në rajonin arab. Këto sesione u fokusuan në mjetet moderne teknologjike dhe marrjen e informacionit përmes burimeve të hapura.

Një seri prej 10 trajnimesh u organizua në partneritet me Google News Initiative, Fondacionin e Gazetarisë Humanitare në Jemen, Rrjetin Irakian për Mediat Sociale, Fakultetin e Komunikimit Masiv në Universitetin Kanadez Ahram dhe me Bernays Media Company në Bahrain.

Rreth 800 gazetarë u pajisën me aplikacione të ndryshme softuerike falas dhe u nis një iniciativë e edukimit dixhital për profesionistët e medias që mbulojnë tema të tilla si teknikat për zhvillimin e mediave, menaxhimin e automatizuar të mediave sociale, marketingun e produkteve dhe mjetet e sigurisë dixhitale.

Projekti fitoi Sfidën e Inovacionit të Google në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe Turqi në konkurrencë me 435 hyrje të tjera, gjë që frymëzoi ekipin për 14 iniciativa të reja duke përdorur zgjidhje AI të patentuara për të lehtësuar punën e gazetarëve.

Si mund ta adoptoni modelin?

Rishikoni me kujdes sistemin e medias në vendin tuaj me një **ekip ekspertësh** dhe **identifikoni fushat problematike. Krijoni partneritete** me institucione publike, organizata ndërkombëtare, kompani mediatike, shoqata profesionale dhe palë të tjera të interesuara **për të hartuar një program gjithëpërfshirës** që trajton çështjet më urgjente. **Angazhohuni me gazetarët** për të kuptuar në thellësi **nevojat dhe ankesat** e tyre, në mënyrë që të gjeni zgjidhjet e duhura korrigjuese dhe transformuese.

Mësoni më shumë:

Faqja e Facebook e Open Source Handbook

3 Koalicioni i Edukimit Mediatik (Media Literacy Coalition): Integrimi i Edukimit Mediatik në Programet Arsimore përmes Fushatave të synuara

Çfarë ka të mrekullueshme ?

Fushata e Ditëve të Edukimit Mediatik organizohet nga Koalicioni për Edukimin Mediatik në Bullgari dhe ka pasur pesë edicione deri në vitin 2022. Edicioni i 2022 u fokusua kryesisht në rolin e mësuesve, arsimin formal dhe joformal dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Zakonisht, Ditët e Edukimit Mediatik fillojnë në Ditën Ndërkombëtare të Internetit më të Sigurtë. Fushata **zgjat rreth 5 muaj** dhe **përfshin trajnime dhe kurse online për mentorë, mësues dhe nxënës si dhe për të moshuar që jetojnë në vendbanime të vogla**; konkurse për mësues; **webinare** për prindërit; **iniciativat kundër dezinformimit dhe verifikimit të fakteve**; prezantimi i **përmbajtjeve të reja edukukative** dhe **testimi i parë kombëtar i aftësive të nxënësve për njohjen e medias dixhitale,** sipas një metodologjie të zhvilluar nga Koalicioni i Edukimit Mediatik (në 2022). Shkollat dhe organizatat e tjera janë të lira të bashkohen në çdo kohë dhe mund të përdorin **programe të gatshme për edukimin mediatik** për të krijuar ngjarjet e tyre ose për të promovuar fushatën. Qëllimi kryesor i fushatës është **integrimi i edukimit mediatik në procesin arsimor** dhe **përmirësimi i edukimit mediatik** për shoqërinë në tërësi. Kjo e fundit kontribuon në **zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe krijimtarisë** jo vetëm **tek fëmijët dhe të rinjtë** që rriten në epokën dixhitale, por edhe **midis grupmoshave të tjera** anembanë Bullgarisë.

Aktualisht, fushata "Ditët e Edukimit Mediatik (Media Literacy Days)" **mbështetet nga një gamë e gjerë organizatash, institucionesh dhe organesh mediatike** - Ministria Bullgare e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Fondacioni Lachezar Tsotsorkov, UNICEF, Fondacioni Amerika për Bullgarinë, Bashkia e Sofjes dhe OFFNews.

Çfarë ka të veçantë kjo iniciativë ?

Ndikimi i "Ditëve të Edukimit Mediatik" është mbarëkombëtar. Ai përfshin ngjarje që zhvillohen në shumë qytete dhe zona rurale bullgare dhe që synojnë nxënësit, mësuesit, mentorët, gazetarët dhe të moshuarit. Nëpërmjet fushatës, Koalicioni për Edukimin Mediatik arrin të përmirësojë aftësitë dhe njohuritë e edukimit mediatik në sistemin arsimor, pra në këtë mënyrë në të gjithë shoqërinë bullgare. Një grup i madh burimesh dhe materialesh u vihet në dispozicion institucioneve dhe organizatave arsimore që janë të gatshme të marrin pjesë në fushatë.

Si mund ta adoptoni modelin?

Transferimi i praktikave nga nisma e Ditëve të Edukimit Mediatik në vende dhe rajone të tjera kërkon **mbështetje nga institucionet qeveritare** që rregullojnë **fushën e arsimit, partnerët mediatikë** dhe **gazetarët. Formati** i fushatave të tilla mund të variojë nga zhvillimi i **klasave për edukimin mbi median dixhitale, tek trajnimet** për mësuesit, studentët dhe mentorët deri te seminaret dhe **sesionet praktike** për më **të moshuar** ose grupet të **pafavorizuara.**

Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e Media Literacy Coalition

Shoqata e Gazetarëve Evropianë - Bullgari WebFaqja

4 **Psaloroco:** Promovimi i Edukimit Mediatik përmes Filmit

Çfarë ka të mrekullueshme "Psaroloco" ?

Projekti Psaroloco mbi Edukimin Mediatik u lançua në Greqi në vitin 2010 dhe menaxhohet nga organizata jofitimprurëse KYKLOS. Ai përmban një program të kuruar me profesionalizëm që përmban **shfaqje në kinema,** të cilat i drejtohen **fëmijëve dhe adoleshentëve,** si dhe një seri grup **workshop-esh** në të cilat fëmijët **krijojnë filma të shkurtër** (trillim, dokumentar, animacion "stop motion", etj.). Një nismë tjetër e projektit është **klasa e Psaroloco Ed.**, kurrikula e së cilës është krijuar për të ofruar **angazhimin nëpërmjet arteve, për të mbështetur edukimin mediatik dhe për të përmirësuar aftësitë e të menduarit kritik.** Në tërësi, projekti promovon **rritjen e të menduarit kritik** dhe **aftësinë për të zbërthyer imazhet** duke familjarizuar audiencat fillestare dhe vulnerabël me **termat bazë të përvojës kinematografike,** përmes një ekspozite filmash, seminaresh, përvojash audiovizuale, ekspozitash dhe seminaresh gjatë Festivalit Ndërkombëtar të zhvilluar nga Psaloroco për Fëmijë dhe të Rinj, si dhe ngjarje të tjera. **Mësuesit e shkollave** janë të integruar në këtë proces dhe përdorin **burime dhe programe edukuese** të përgatitura posaçërisht për të vepruar si **agjentë kryesorë të edukimit audiovizual.**

Një prioritet kyç i Psaroloco është **shtrirja në zona gjeografike** të Greqisë ku kontakti me njohuritë mbi median dhe informacionin është i **kufizuar** ose nuk ka aspak.. Krijimi i marrëdhënieve të ngushta dhe organike me njerëzit që jetojnë në këto komunitete është prioritet mbi të cilin po punohet vit pas viti dhe synohet fuqizimi i tyre.

Që nga themelimi i saj Psaroloco **ka bashkëpunuar** me **Fshatin e Fëmijëve "SOS"** të Greqisë dhe **OJF Tandem** për zhvillimin e seminareve eksperimentale në Qendrën për Rehabilitimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Attica (K.A.A.A.P.A.A.A., dikur P.I.K.P.A.A. Voula).

Çfarë ka të veçantë "Psaroloco"?

Programi arsimor është i hapur dhe i aksesuesshëm për të gjithë përmes faqes zyrtare të internetit, e cila i mundëson të rinjve dhe të moshuarve ta kërkojnë dhe eksplorojnë mbi këtë program. Ndikimi pozitiv tek mësimdhënësit, prindërit, klubet e filmit, stafi i bibliotekës dhe kineastët e rinj është i dukshëm nga ftesat dhe pyetjet e marra nga e gjithë bota. Zbatimi i programit rriti pjesëmarrjen e nxënësve dhe mirëkuptimin e ndërsjelltë midis tyre në klasë. Ka patur një përmirësim të dukshëm në aftësitë e të menduarit kritik, në aftësitë lidhur me vëzhgimin-përqëndrimin, në kërkimin e kuptimeve dhe në aftësinë për të dalluar marrëdhëniet midis fushave të ndryshme. Për më tepër, Projekti i Edukimit Mediatik Psaloroco ishte ndër fituesit e

Çmimeve Globale të UNESCO-s për Edukimin mediatik dhe informativ 2021.

Aktivitetet e projektit rritën ndërgjegjësimin për çështjet e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe i vendosën ato në axhendën e mësuesve duke promovuar mendimin e lirë, pjesëmarrjen në proceset demokratike, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut duke përfshirë të drejtat e pakicave.

Si mund ta adoptoni këtë model?

Projekti Psaroloco Media Literacy **ofron të gjitha burimet edukuese** në anglisht **pa pagesë** përmes faqes zyrtare të projektit. Bashkëpunimi me institucione, organizata, akademikë dhe krijues nga rajone të tjera nëpërmjet **programeve të përbashkëta të trajnimit dhe kërkimit** ndihmon në zhvillimin e qasjeve tematike dhe teknikave të reja.

- Paketa edukative e bazuar në filmin e animuar "Për nënën" nga Dina Velikovskaya me tema: nëna, familja, dashuria, mbështetja reciproke, ndërkulturalizmi. Mosha e sugjeruar 10-12+
  Linku : https://www.psaroloco.org/about-a-mother
- Paketa edukative e bazuar në filmin "Dhelpra" nga Jacqueline Lentzou me tema: mosha e rritur, familje, fëmijëri, konflikt. Mosha e rekomanduar: 14+
  Linku: https://www.psaroloco.org/education-kit-fox
- Paketa edukative e bazuar në filmin "Thermost 6" nga Maya Av-Ron & Marion Coudert & Mylene Cominotti & Sixtine Dano me tema: ndryshimet klimaterike dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Mosha e rekomanduar: 12+
  Linku: https://www.psaroloco.org/thermostat-6-climate-change-sdgs
- Paketat edukative "Let's get real" me tema: eksplorimi mbi krijimin e filmave dokumentarë. Paketa lejon nxënësit të mësojnë gjuhën vizuale të nevojshme për të treguar një histori përmes kësaj forme dhe të kuptojnë procesin e përzgjedhjes që përfshin tregimi i një historie. Mosha e rekomanduar: 12-16+
  Linku: https://www.psaroloco.org/memory-%CE%B9-let-s-get-real

Mësoni më shumë:

Filmat sipas temave dhe grupmoshave

Festivali i filmit Psaloroco



5 Rrjeti I Organizatave të Edukimit Mediatik (Media Literacy Network Organization): Promovimi i Përdorimit të Sigurt dhe të Zgjuar të Medias Përmes Bashkëpunimit

Çfarë ka të mrekullueshme ?

Netwerk Mediawijsheid (Rrjeti Hollandez i Edukimit Mediatik) është një **rrjet** i përbërë nga **më shumë se një mijë organizata** që punojnë **së bashku për të krijuar një shoqëri holandeze** të edukuar mbi median. Këto janë institucione arsimore, institucione kulturore, qendra kërkimore, kompani ICT, platforma mediatike, etj. Të gjitha këto sjellin diçka ndryshe, një perspektivë të re në dialog. I krijuar si një iniciativë e Ministrisë së Arsimit, Kulturës dhe Shkencës, **rrjeti lehtëson shkëmbimin e njohurive** dhe **bashkëpunimin** për të zbatuar aktivitete që **promovojnë edukimin mediatik.** Sigurimi i një edukimi të tillë është thelbësor për një shoqëri demokratike mirëfunksionale. Ai i ekspozon njerëzit ndaj **mundësive që mund të ofrojë media,** si dhe ndaj **rreziqeve që lidhen me të.**

Rrjeti nisi një plan shumëvjeçar në vitin 2019 me misionin 'Të gjithë të edukuar rreth medias'. Për ta arritur këtë, organizata fokusohet **në tre aktivitete kryesore:** ngritja e **ndërgjegjësimit dhe përcaktimi i metodologjisë,** reflektimi **mbi praktikat dhe politikat e ndjekura** dhe ndërtimi i një **rrjeti përforcues dhe aktivizues.** Duke përdorur fuqitë e tij më të mëdha si **njohuritë, ekspertizën dhe burimet** e përbashkëta, ndërgjegjësimi mbi **rëndësinë e edukimit mediatik** është sjellë përmes **fushatave**, nismave, projekteve, **mjeteve** dhe **modeleve.**

Çfarë ka të veçantë ?

Në vitin 2010, filloi fushata "Java e Edukimit Mediatik". Çdo vit tema është e ndryshme: edukimi mediatik i të rinjve (2011), ndikimi i medias në jetën e njerëzve (2012), të drejtat mbi edukimin mediatik (2014), dallimi midis fakteve, lajmeve të rreme dhe çinformimin (2016), balanca dixhitale (2020). Fushata targeton moshat e reja që sa kanë kaluar adoleshencën dhe ofron këshilla dhe informacione mbi tema të ndryshme, përfshirë diskutimin e vitit 2022 mbi simulimin e sjelljes sociale në internet.

Faqja zyrtare e internetit Mediawijsheid.nl ofron informacion në lidhje me përdorimin e sigurt dhe të zgjuar të mediave dixhitale. Ajo ka seksione të shumta nga të cilat një person mund të lundrojë dhe të zgjedhë, duke përfshirë mënyrën se si të merret me problemet që lindin nga përdorimi i mediave sociale, dezinformimi dhe si të jetë i sigurt në internet. Faqja e internetit ka më shumë se 450,000 vizitorë çdo vit.

Ky rrjet është fokusuar edhe te dezinformimi, një problem në rritje. Si i tillë, faqja e internetit Isdaechtzo.nl u zhvillua për të informuar përdoruesit në lidhje me përhapjen e lajmeve të rreme, mënyra se si funksionon dhe si të tregojë nëse informacioni është i besueshëm apo jo.

Si mund ta adoptoni modelin?

Shumica e të rinjve tashme janë rritur rreth botës dixhitale, por nuk janë të vetëdijshëm se si t'i shfrytëzojnë këto mundësi apo të mbrohen nga rreziqet. Iniciativa të tilla për përmirësimin e edukimit mediatik janë çelësi i një shoqërie që funksionon mirë. Netwerk Mediaijsheid, si një **praktikë e mirë,** mbështetet **tek bashkëpunimi** duke u përpjekur **për të takuar, punuar dhe lidhur** me **sa më shumë partnerë**, që kanë **fokus të ngjashëm mbi edukimin mediatik. Sa më i madh të jetë rrjeti,** aq më i **madh është ndikimi** që mund të arrihet.

Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e Netwerk Mediawijsheid

Portali online i dedikuar përdorimit të sigurt dhe të zgjuar të mediave dixhitale

Nisma që targeton lajmet e rreme dhe dezinformimin



Shembuj Konkretë të Gazetarisë Qytetare
Siguria në internet & Programet e Mbështetjes Profesionale

1 Qytetaria Dixhitale dhe Parandalimi i Zhvatjeve Kibernetike: Mësoni si të Qëndroni të Informuar dhe të Sigurt në Internet

Çfarë ka të mrekullueshme ?

Nisma u lançua në vitin 2021 nga Rrjeti Arab për Media Dixhitale dhe të Drejtat e Njeriut **në përgjigje** të disa **tendencave shqetësuese**: përhapja e **lajmeve të rreme,** shfaqja e një **fenomeni si vetëvrasja** midis vajzave të reja **të ndikuara nga interneti** dhe rënia e **besueshmërisë ndaj disa faqe lajmesh** në Egjipt.

I vetëfinancuar nga anëtarët e Rrjetit, ai përbëhet nga **një seri seminaresh online** për gazetarë, profesionistë të medias dhe studentë të medias mbi **përdorimin e mjeteve të verifikimit të fakteve** dhe **aspektet e shumta të qytetarisë dixhitale.** Përveç kësaj, iniciativa ngriti **ndërgjegjësimin mbi bullizmin kibernetik** dhe **zhvatjen kibernetike me anë të videove të dedikuara** që paraqesin mënyra për të **mbështetur viktimat** e këtyre praktikave keqdashëse.

Organizata që qëndron pas nismës - Rrjeti Arab për Media Dixhitale dhe të Drejtat e Njeriut, u themelua nga një **gazetar** me **përvojë 20 vjeçare** dhe **dy profesorë universiteti**. Ai i është përkushtuar **promovimit të të drejtave të njeriut,** mbështetjes së lirisë së shprehjes dhe **edukimit** të publikut mbi **përfitimet nëpërmjet mjeteve të qytetarisë dixhitale** që nga viti 2019.

Çfarë ka të veçantë ?

Një numër i madh ndjekësish i të Rrjetit në mediat sociale kërkuan të merrnin pjesë në seminare dhe workshop-e në mënyrë që të mund të mësonin më shumë rreth llojeve të zhvatjes kibernetike dhe mjeteve për t'u ofruar ndihmë viktimave. Anëtarët e ekipit të Rrjetit vlerësojnë rëndësinë e praktikave të tyre në baza të rregullta duke shqyrtuar reagimet nga pjesëmarrësit në iniciativë. Bazuar rezultateve pas çdo rishikimi janë bërë përmirësime dhe janë prezantuar qasje të reja.

Si mund ta adoptoni modelin?

Përcaktoni **rolin e mediave sociale në përhapjen e thashethemeve** dhe **informacioneve të pasakta** dhe **trajtoni disa aspekte** të problemit duke **përfshirë influencues** që janë të njohur në mesin e të rinjve, **inovativë** dhe **të gatshëm për të**

përdorur praktika profesionale gazetareske në **prodhimin e përmbajtjes** për qëllimet e projektit tuaj. Gjithmonë **merrini në konsideratë mendimet e Gjeneratës Z** dhe mos anashkaloni **zgjidhjet jokonvencionale** që ato ofrojnë pasi këto shpesh **rezultojnë shumë efektive** në **adresimin e praktikave të gabuara mediatike** në internet.

Mësoni më shumë :

Rritja e edukimit dixhital

Parandalimi i bullizmit kibernetik dhe shantazit kibernetik



2 Mbështetja e Mediave Ndërkombëtare (International Media Support): Ndihmë ndaj Gazetarëve në Vendet e Goditura nga Konfliktet dhe Krizat Politike

Çfarë ka të mrekullueshme kjo organizatë?

International Media Support (IMS) është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse që **mbështet mediat lokale** në **vendet** e prekura **nga konflikti i armatosur, sundimi autoritar dhe tranzicioni politik.** IMS është e përkushtuar **për të mbrojtur lirinë e shprehjes** dhe standardet ndërkombëtare të **të drejtave të njeriut** të miratuara nga komuniteti ndërkombëtar. IMS vepron si **një mekanizëm mbështetës** për **kolegët profesionistë, mediat e pavarura** dhe **institucionet e tjera të lidhura me median**. Organizata **inkurajon lirinë e shtypit, shpëton jetën e gazetarëve** dhe hap rrugën për një **gazetari të mirë** dhe informacion të besueshëm për të gjithë.

Sot, IMS **operon në më shumë se 30 vende,** ku ekziston **rreziku për ruajtjen e mediave të pavarura** për shkak të krizave humanitare ose politike, regjimeve autoritare dhe konflikteve të armatosura. Siç thotë motoja e IMS *"Gazetari e mirë, Shoqëri më të mira".* IMS shtyn drejt **gazetarisë cilësore, sfidon ligjet represive** dhe **i mban punonjësit e mediave** të të gjitha gjinive **të sigurt** në mënyrë që ata të mund të bëjnë punën e tyre. Organizata ka adoptuar **disa parime udhëzuese:**

- IMS do të veprojë **në interes të publikut** dhe do të ruajë **pavarësinë** e tij nga qeveritë, korporatat fitimprurëse, donatorët dhe organizatat politike;
- IMS do të jetë **e ndjeshme ndaj vlerave morale,** fesë, zakoneve, traditave dhe kulturës së komuniteteve ku punon.
- IMS synon **të punojë përtej kufijve të politikës,** fesë, kulturës, racës dhe përkatësisë etnike në bashkëpunim edhe me **organizata** dhe individë që **ndajnë të njëjtat vlera dhe objektiva**.
- IMS përpiqet të sigurojë që **iniciativat e zhvillimit të medias të formësohen** si nga ana e standardeve ndërkombëtare mbi **të drejtat e njeriut** ashtu edhe nga **prioritetet e çdo vendi** ku organizata operon.

Çfarë ka të veçantë ?

Gazetari e Mirë

IMS kërkon të mbështesë mediat lokale dhe përmbajtjen që ofrojnë më anë të:

● Ofrimit të trajnimeve mbi raportimin e mirë dhe zhanret e gazetarisë si p.sh. gazetaria investigative;

● Përgatitja e materialeve të trajnimit, përfshirë manualet dhe udhëzuesit e trajnerëve mbi modelet e praktikave më të mira;

● Zhvillimi i strukturave të biznesit mediatik përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit, gjenerimit të të ardhurave përmes reklamave e shitjeve dhe zhvillimit të teknikave inteligjente të shpërndarjes;

● Forcimi i lidhjeve ndërmjet medias, shoqërisë civile, organizatave humanitare dhe akademisë për të zgjeruar aksesin e medias në informacion;

● Mbështetja e prodhimit të filmave dokumentarë si platforma alternative për zërat dhe pikëpamjet mbi çështjet që rrallë mbulohen në mediat kryesore.

Siguria e Gazetarëve

Si pjesë e punës së IMS për të mbështetur ndërtimin e mekanizmave kombëtarë të sigurisë për gazetarët me praninë e partnerëve vendas, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, qasja ndaj sigurisë për gazetarët kombinon trajnimin e specializuar me masat praktike të sigurisë dhe mbrojtjen për mjedise më të sigurta pune në media.

Liria e Shtypit

Në vendet ku liria e shtypit është e kufizuar, IMS bashkëpunon me partnerët e mediave lokale për të promovuar ligje që sigurojnë kushte më të mira pune për gazetarët, duke mbrojtur lirinë e shprehjes në platformat tradicionale dhe dixhitale dhe duke nxitur miratimin e ligjeve të përmirësuara në lidhje me median.

Axhenda Globale

IMS trajton gjithashtu çështje globale që ndikojnë në zhvillimin e medias së lirë, si varfëria, korrupsioni, migrimi dhe radikalizimi.

Film Dokumentar

IMS punon me regjisorë të pavarur nga e gjithë bota për të zhvilluar projekte të reja, për t'u lidhur me industritë e filmit dhe për të mundësuar rrëfimin bashkëpunues që krijon ndikim dhe kontribuon në zhvillimet sociale, politike dhe kulturore.

Si mund ta adoptoni modelin?

Për adoptimin e një praktike të ngjashme, **elementët më të rëndësishëm të gazetarisë së mirë** duhet të jenë **të dukshëm.** Ata përfshijnë ofrimin **e përmbajtjes e cila është etike, aktuale, kritike dhe me interes publik,** duke siguruar **raportim të paanshëm dhe objektiv.** Qytetarët kanë nevojë për informacion të saktë për të marrë vendime për veten dhe komunitetin e tyre.

Mësoni më shumë:

Faqja zyrtare e International Media Support

3

Sofizmi (Sophism): Luftimi i Gjuhës së Urrejtjes Përmes Ndërgjegjësimit dhe Edukimit

Çfarë ka të mrekullueshme "Sophism" ?

Qendra për të Drejtën Kushtetuese Evropiane (CECL) së bashku me Universitetin Kombëtar dhe Kapodistrian të Athinës (NKUA), EDEX – Educational Excellence Corporation Ltd (Universiteti i Nikosias) dhe Lidhja Helenike për të Drejtat e Njeriut po zbatojnë projektin e titulluar SOpHiSM **si përgjigje kundër gjuhës së urrejtjes në internet - një problem në rritje** në Greqi dhe Qipro, i cili mund t'i atribuohet qëndrimeve shoqërore ndaj grupeve specifike, zhvillimit të mediave online dhe mungesës së ndërgjegjësimit dhe të mjeteve të përshtatshme për të luftuar gjuhën e urrejtjes. Gazetarët profesionistë dhe qytetarë të thjeshtë po **prodhojnë përmbajtje** që përmbajnë **gjuhë urrejtjeje**, qoftë **me dashje**, për **të fituar shikueshmëri, si dhe pa dashje**, sepse **nuk janë në gjendje ta dallojnë atë në mënyrë efektive.** Projekti synon **të mbështesë gazetarinë me cilësi të lartë** në Greqi dhe Qipro përmes **përmirësimit të aftësive të gazetarëve profesionistë mbi edukimin mediatik** dhe **qytetarëve** (blogerë, ndikues të mediave sociale) dhe **të ndihmojë gazetarët të dallojnë menjëherë modelet e gjuhës së urrejtjes në internet** dhe t'i nxisin ata **të prodhojnë gazetari kundër gjuhës së urrejtjes.** Ai synon gjithashtu **të rrisë ndërgjegjësimin e publikut** të gjerë për veçoritë e gjuhës së urrejtjes në internet nëpërmjet një fushate on-line, **që ndjek një qasje pjesëmarrëse, me orientim nga poshtë lart,** përmes krijimit të **një aleance të udhëhequr** nga të rinjtë e përbërë nga qytetarë dhe gazetarë profesionistë. Ndër objektivat e tjera të projektit janë **ndërtimi i një biblioteke dixhitale** mbi gjuhën e urrejtjes në internet në Greqi dhe Qipro dhe zhvillimi **i mjeteve** që do të targetojnë **raste specifike** të gjuhës së urrejtjes.

Çfarë ka të veçantë ?

Pjesëmarrësit në aktivitetet trajnuese dhe anëtarët e aleancës të udhëhequr nga të rinjtë u aftësuan nëpërmjet materialeve dhe mjeteve mësimore me cilësi të lartë dhe fituan përvojë praktike lidhur me temën e gjuhës së urrejtjes në internet, e cila përbën një sfidë relativisht të re që nuk adresohet siç duhet në kurrikulat shkollave greke dhe qipriote të gazetarisë.

Pothuajse 400 studentë të gazetarisë, gazetarë të rinj dhe gazetarë qytetarë morën pjesë në seminare online (duke përfshirë sesione teorike dhe praktike) në Greqi dhe Qipro, duke u fokusuar në gjuhën e urrejtjes dhe duke diskutuar rrënjët e thella sociale të fenomenit, artikulimin e saj në sferën publike dhe mënyrat e shmangies së të artikuluarit të gjuhën e urrejtjes. Ndikimi afatmesëm dhe afatgjatë i aktivitetit lidhet me elementët e tij të qëndrueshëm dhe ka të bëjë me disponueshmërinë e materialeve dhe mjeteve edukuese për gazetarët, studentët e gazetarisë, gazetarët qytetarë dhe personat e tjerë të interesuar në Greqi dhe Qipro pas përfundimit të projektit dhe në të ardhmen.

Përafërsisht gjysma e pjesëmarrësve kanë qenë të përfshirë në "aleancën kundër gjuhës së urrejtjes", përmes së cilës ata kanë prodhuar tekste, aktualisht të disponueshme në "seksionin e portalit" të faqes zyrtare të internetit të SOpHiSM. Këta

tekste diskutojnë aspekte të ndryshme të gjuhës së urrejtjes, si në internet ashtu edhe jashtë tij. Prodhimi dhe ngarkimi në web i përmbajtjes vazhdon edhe pas përfundimit të programit, pasi gjuha e urrejtjes është futur si temë në dy lëndë universitare në Departamentin e Studimeve të Komunikimit dhe Medias të NKUA-së dhe Departamentin e Komunikimit dhe Mediave Dixhitale të UoËM.

Si mund ta adoptoni modelin?

Identifikoni rastet më të përhapura të gjuhës së urrejtjes **në mediat online** dhe **rrjetet sociale** dhe **eksploroni kontekstet sociale, paragjykimet dhe keqkuptimet** pas tyre në mënyrë **që të hartoni një fushatë efektive edukative** që **pasqyron specifikat kulturore,** teknologjike dhe **gjuhësore.**

Ajo që ofron **SOphiSM është e rëndësishme për vendet e tjera të BE-së** përtej partneritetit. **Metodologjia** e përdorur, veçanërisht në lidhje me portalin **e lajmeve në internet kundër gjuhës së urrejtjes,** mund të **transferohet** në kontekste të ndryshme kombëtare. Transferueshmëria bëhet e mundur, sepse shumë nga **rezultatet e projektit** janë të disponueshme **në gjuhën angleze.**

Mësoni më shumë:

SOpHiSM's website

4 Digital Legal Clinic: Luftimi i Çinformimit dhe Bërja e Internetit një Vend më të Sigurt



Çfarë ka të mrekullueshme ?

"Digital Legal Clinic" është **një iniciativë e udhëhequr nga gratë,** e dedikuar për ofrimin e mjeteve të duhura për **mbrojtjen nga ngacmimet në internet** dhe **krimet elektronike**, duke **rritur aftësitë dixhitale të të rinjve** dhe duke rritur **ndërgjegjësimin** për **efektet e çinformimit**, **ndërveprimit midis teknologjisë** dhe kornizave **ligjore** dhe parimeve **mbi sjelljen e përgjegjshme në internet.** Qëllimi i nismës është **krijimi i një hapësire të sigurt kibernetike** dhe **transformimi** i **sfidave dixhitale në mundësi punësimi.** Në këtë pikë, Klinika përbëhet nga disa departamente për të adresuar një gamë të gjerë nevojash të njerëzve dhe u përmbahet **politikave strikte të privatësisë** gjatë aktiviteteve të saj, pasi shumë prej tyre përfshijnë ndihmën ndaj viktimave të reja në raste të ndjeshme si zhvatja dhe bullizmi në internet. **Programet edukuese dhe ngritja e kapaciteteve** janë krijuar për të përfituar **aftësi të gjera** dixhitale dhe përfshirë **kurrikulat** ligjore, në mënyrë që pjesëmarrësit të përgatiten më mirë për kërkesat e tregut të punës. Përveç kësaj, anëtarët e ekipit të Klinikës Ligjore Dixhitale mbajnë **seminare në internet** që mbulojnë **kodin penal, parimet e mediave sociale** dhe **fushatat ndaj lajmeve të rreme** në mënyra që i bëjnë këto tema interesante për audiencën që eshtë në moshë të re.

E gjithë nisma u krijua gjatë **pandemisë së COVID-19** dhe **bllokimit** që pasoi, si rezultat i nxitjes së themeluesve **për të adresuar në mënyrë efiçente ankesat** e **një numri në rritje** të vajzave dhe djemve që ishin **të ekspozuar ndaj dhunës dixhitale** dhe taktikave të **ngacmimit në internet,** duke filluar nga bullizmi kibernetik tek racizmi dhe zhvatja.

◆ **Çfarë ka të veçantë "Digital Legal Clinic"?**

Digital Legal Clinic zgjidhi teknikisht afro 4,000 krime kibernetike dhe ua dorëzoi ekipeve të kualifikuara ligjore dhe autoriteteve përkatëse shtetërore. Për më tepër, rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me kuadrin ligjor të vendit dhe rregulloret e ndryshme kibernetike midis ish-viktimave rezultoi vendimtare për ndërtimin e strategjive të mbrojtjes në internet dhe mbrojtjes ndaj sulmeve të dhunshme. Rreth 5,000 pjesëmarrës në programe të ndryshme edukuese përmirësuan njohuritë e tyre dixhitale dhe fituan aftësi të reja të vlefshme. Si pjesë e nismës, u krijua një rrjet që ofron mundësi karriere për vajzat e reja në fushën e zhvillimit të lojërave.

Iniciativa tërhoqi mbështetje financiare nga 10 000 dashamirës nga Jordania dhe Lindja e Mesme, duke siguruar kështu burimet e nevojshme për veprimtarinë e saj afatgjatë.

◆ **Si mund ta adoptoni modelin?**

Identifikoni taktikat më të zakonshme **të përdorura për bullizmin kibernetik**, **përhapjen e dezinformatave në internet** dhe **hartoni strategji** efikase për t'i kundërshtuar ato së bashku me **profesionistë** nga fusha **e medias, Teknologjisë së Informacionit (IT) dhe kuadrit ligjor.**

Krijoni partneritete me **specialistë të marketingut dixhital** për të krijuar **fushata që nxjerrin në pah efektet** e rrezikshme **të lajmeve të rreme** dhe për të rritur **ndërgjegjësimin mbi mjetet mbrojtjese** nga ngacmimet në internet.

◆ **Mësoni më shumë:** Faqja në Facebook e Klinikës Ligjore Dixhitale



Digital Legal Clinic

KONKLUZIONE

Ky udhëzues motivues për gazetarinë qytetare prezantoi 21 praktika të mira që përmbledhin thelbin e kësaj fushe duke ofruar njohuri dhe ide të vlefshme për gazetarët qytetarë, aspirantë si ju. Tashmë, me një kuptim më të thellë mbi rëndësinë e Gazetarisë Qytetare, shpresojmë që ky udhëzues t'ju ketë fuqizuar, frymëzuar dhe ndihmuar që të angazhoheni më tej me komunitetin tuaj, në mënyrë që të mund të raportoni për çështjet që kanë rëndësi. Ky udhëzues synon gjithashtu të inkurajojë gazetarinë e përgjegjshme dhe etike dhe të nxisë llogaridhënien dhe transparencën në terren. Duke ndjekur shembujt e praktikave të prezantuara dhe parimet e përshkruara në këtë udhëzues, ne besojmë se ju mund të jepni një kontribut të rëndësishëm jo vetëm në fushën e gazetarisë qytetare, por edhe në kontekstin e komunitetit tuaj.

Gama e praktikave më të mira të paraqitura në seksionet e mëparshme nxjerr në pah mjaft **fusha** në të cilat mund **të orientoni përpjekjet tuaja** si **gazetar qytetar.** Nuk është e domosdoshme të jeni profesionist i videove në smartfonin tuaj ose të ktheheni në një fotograf profesionist në mënyrë që të prodhoni përmbajtje mbresëlënëse dhe të ndihmoni audiencën tuaj të gjejë të vërtetën rreth ngjarjeve aktuale. **Aftësitë e mira kërkimore, analitike, programuese, dizenjuese, menaxhuese dhe shkruese** janë po aq **të vlefshme** për të nisur një **projekt gazetaresk qytetar tërheqës dhe përfitues,** por mbi të gjitha, ju duhet **të jeni të përkushtuar, të keni bazat e edukimit mediatik dhe të jeni kurioz** në kërkim të çështjeve të rëndësishme të komunitetit tuaj. **Kërkoni gjithmonë bashkëpunime** me persona entuziastë të tjerë të aftë, në mënyrë që të mund të kryeni hetime të plota, të maksimizoni shtrirjen e audiences së publikimeve tuaja,të krijoni programe edukuese, platforma te verifikimit të fakteve ose revista online. Cilado qoftë mënyra që zgjidhni për të ndjekur **gazetarinë qytetare**, **qëndroni besnikë ndaj vetes,** jini **të guximshëm** dhe respektoni **kodin e mëposhtëm të etikës** [5,8]**:**

- Luftoni për lirinë e shtypit;
- Përkushtohuni për të gjetur të vërtetën edhe nëse kjo bie ndesh me bindjet tuaja politike ose përfshin sfidimin e status quo-së;
- Mos merrni pjesë në shoqata dhe aktivitete që mund të rrezikojnë pavarësinë dhe integritetin tuaj gazetaresk në sytë e publikut;
- Hetoni të gjitha anët e një historie dhe mblidhni të dhënat nga të gjitha palët e prekura;
- Bëjeni atribuimin një prioritet kryesor, pra citoni gjithnje burimet e informacionit;
- Respektoni njerëzit nga të gjitha sferat;

- Merrni përgjegjësinë për gabimet tuaja dhe korrigjojini ata menjëherë;
- Shmangni plagjiaturën;
- Mos iu nënshtroni paragjykimeve dhe njëanësive si: konfirmimi (kërkoni informacion që mbështet bindjet tuaja), kujtime të rreme, dëshirë e fortë për të krijuar një histori koherente edhe kur ju mungojnë disa nga faktet, ankorimi (mbështetja më tepër seç duhet në faktin e parë që zbuloni), efekti i konsensusis të rremë (mbivlerësimi i popullaritetit të ideve tuaja mbi atë të njerëzve të tjerë) apo keqinformimi.

Duke iu përmbajtur këtyre parimeve etike, ju jo vetëm që do të fitoni besimin e audiencës tuaj, duke demonstruar përkushtimin tuaj të plotë ndaj së vërtetës, por gjithashtu do të promovoni profesionalizmin, transparencën, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë në sy të komunitetit dhe bashkëmoshatarëve tuaj. Ne gjithashtu shpresojmë që nëntë pikat kryesore që kemi renditur më sipër do t'ju vijnë në ndihmë gjatë komunikimit të reportazheve me ndikim të lartë dhe gazetarisë kuptimplotë.

Epo tani është koha për të dalë në terren, për të bashkëvepruar me anëtarët e komunitetit tuaj, për të zbuluar një histori emocionuese dhe **për të bërë një ndryshim** në sajë të **raportimit tuaj**. Nëse keni ndonjëherë dyshime lidhur me ndonjë aspekt të caktuar të prodhimit mediatik, na kontaktoni përmes formularit të kontaktit në faqen tonë të internetit: https://jour-you.eu/contacts/. Ne do t'ju ndihmojmë me kënaqësi!

Dhe gjithmonë mbani mend se një raportim i vërtetë, objektiv dhe i bazuar në prova mund të demaskojë një mori narrativash të rreme dhe të ndryshojë jetën e njerëzve për mirë.

Paçi fat!



REFERENCA

1. Rose, S. (2013, Nov. 14). *Abraham Zapruder: the man behind history's most infamous home movie.* The Guardian. https://www.theguardian.com/film/2013/nov/14/abraham-zapruder-film-kennedy-killing-parkland

2. Rosen, J. (2014, July 14). A Most Useful Definition of Citizen Journalism. Retrieved June 3, 2022, from A Most Useful Definition of Citizen Journalism: http://archive.pressthink.org/2008/07/14/a_most_useful_d.html

3. Mare, A., Keith, H., Marimbe, S., & Mukundu, R. (2018). *Citizen Journalism Guidelines on electoral reporting in Zimbabwe.* Denmark: International Media Support (IMS).

4. Riaz, S., & Pasha, S. A. (2011). Role of citizen journalism in strengthening societies. *FWU Journal of Social Sciences, 5*(1), 88-103.

5. Ross, R., & Cormier, S. C. (2010). *Handbook For Citizen Journalists.* Denver: National Association of Citizen Journalists.

6. Knight Citizen News Network. (2014). *Principles of Community Journalism*. http://kcnn.org/learning-modules/principles-of-citizen-journalism/

7. Hobbs, R. (2010). *Digital and Media Literacy: A Plan of Action.* Queenstown: The Aspen Institute.

8. Citizen Journalism Academy for Youth. (2022) *T 2.3 Methodology for Creating Training Materials.* JOUR-YOU Project Team (produced by Elisavet Vasileiou /EKO Greece/ and consulted with the project partners).



Udhëzues për Rininë mbi Gazetarinë Qytetare

Version 1.01 15 May 2023

Copyright: Mihail Minchev

Editues: Nevena Dobreva dhe Mariya Rachinska
Design & Layout: Stanislav Evstatiev / 4 FRIENDS STUDIO
Vector art: Vecteezy.com
Sofje, Bullgari, 2023

Ky publikim është botuar nën një licensë krijuese të përbashkët
https://creativecommons.org/licenses/by-nd/4.0/

Ky publikim është i disponueshëm për t'u shkarkuar
me akses të hapur në https://jour-you.eu



jour-you.eu